606	Trans për buxh. fam & individ	230						0
609								
651								
166								
Nëntotali	Shpenzime korrente							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara	4,820	9,500	9,500	9,500			0
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							
Totali	Shpenzime kapitale							
	Totali (korrente + kapitale)	89,586	135,755	135,755	151,401	95,594	49,022	-46,572
Drejtuesi I Ekipit	Emri	Kryetari I Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri				
Menaxhues t								
Programit								
		Firma				Firma		
	Data			Data				

Bashkia	Vlore						Kodi I grupit/Njesise vendore	146001
Programi	Shumesportesh						Kodi I programit	8140
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2022	2 .PBA Plan Viti 2023	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2023	34. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2023	5.Buxheti vjetor Plani I peroidhes/progresiv	6. Fakti I periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	10,274	11,362	11,362	11,362	9,350	7,203	-2,147
601	Sigurime shoqërore	1,711	1,897	1,897	1,897	1,600	1,192	-408
602	Mallra dhe shërbime të tjera	31,147	39,863	39,863	39,863	36,706	32,405	-4,301
603	Subvencione							
604	Transferta korrente të brendshme							
605	Transferta korrente të huaja							
606	Trans për buxh. fam & individ							
609								
651								
166								
Nëntotali	Shpenzime korrente							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara		20,000	20,000	103,411	83,411	0	-83,411
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							
Totali	Shpenzime kapitale							
	Totali (korrente + kapitale)	43,132	73,122	73,122	156,533	131,067	40,800	-90,267
Drejtuesi I Ekipit	Emri	Kryetari I Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri				
Menaxhues t								
Programit								
		Firma				Firma		
	Data			Data				

Bashkia	Vlore						Kodi i grupit/Njesise vendore	146001	
Programi	Qendra Kulturore						Kodi I programit	8250	
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2022	2 .PBA Plan Viti 2023	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2023	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2023	5.Buxheti vjetor Plan I peroidhes/progresiv	6. Fakti I periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
600	Paga	18,018	28,767	28,767	28,767			0	
601	Sigurime shoqërore	2,991	4,116	4,116	4,116			0	
602	Mallra dhe shërbime të tjera	16,339	10,730	10,730	21,147			0	
603	Subvencione								
604	Transferta korrente të brendshme								
605	Transferta korrente të huaja								
606	Trans për buxh. fam & individ	410						0	
609									
651									
166									
Nëntotali	Shpenzime korrente								
230	Kapitale të patrupëzuara								
231	Kapitale të trupëzuara								
232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm								
230	Kapitale të patrupëzuara								
231	Kapitale të trupëzuara	2,035	4,000	4,000	26,185	22,185	0	-22,185	
232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj								
Totali	Shpenzime kapitale								
	Totali (korrente + kapitale)	39,793	47,613	47,613	80,215	22,185	0	-22,185	
Drejtuesi I Ekipit	Emri	Kryetari I Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri					
Enxhues i Programit									
		Firma				Firma			
		Data				Data			

Bashkia	Vlore						Kodi i grupit/Njesise vendore	146001	
Programi	Teatri						Kodi I programit	8280	
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2022	2 .PBA Plan Viti 2023	vjetor Plan fillestar Viti 2023	vjetor Plan I rishikuar Viti 2023	vjetor Plan I peroidhes/progresiv	6. Fakti I periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
600	Paga	18,735	22,615	22,615	22,615	15,290	12,553	-2,737	
601	Sigurime shoqërore	3,122	3,600	3,600	3,600	2,620	2,067	-553	
602	Mallra dhe shërbime të tjera	6,544	9,450	9,450	9,450	7,050	5,467	-1,583	
603	Subvencione								
604	Transferta korrente të brendshme								
605	Transferta korrente të huaja								
606	Trans për buxh. fam & individ	400						0	
609									
651									
166									
Nëntotali	Shpenzime korrente								
230	Kapitale të patrupëzuara								
231	Kapitale të trupëzuara								
232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm								
230	Kapitale të patrupëzuara								
231	Kapitale të trupëzuara	791	3,200	3,200	3,200	100	50	-50	
232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj								
Totali	Shpenzime kapitale								
	Totali (korrente + kapitale)	29,592	38,865	38,865	38,865	25,060	20,137	-4,923	
Drejtuesi I Ekipit	Emri	Kryetari I Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri					
Enxhues i Programit									
		Firma				Firma			
		Data				Data			

Bashkia	Vlore						Kodi i grupit/Njesise vendore	146001	
Programi	Arsimi Parauniversitar						Kodi I programit	9120	
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2022	2 .PBA Plan Viti 2023	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2023	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2023	5.Buxheti vjetor Plan I peroidhes/progr esiv	6. Fakti I periudhës/progr esiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
600	Paga	245,598	275,869	275,869	324,417	238,412	182,359	-56,053	
601	Sigurime shoqërore	40,789	46,129	46,129	54,236	39,147	30,268	-8,879	
602	Mallra dhe shërbime të tjera	43,623	60,793	60,793	60,793	37,500	26,679	-10,821	
603	Subvencione								
604	Transferta korrente të brendshme								
605	Transferta korrente të huaja								
606	Trans për buxh. fam & individ	6,570						0	
609									
651									
166									
Nëntotali	Shpenzime korrente								
230	Kapitale të patrupëzuara								
231	Kapitale të trupëzuara								
232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm								
230	Kapitale të patrupëzuara								
231	Kapitale të trupëzuara		33,866	33,866	185,713	151,847			
232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj								
Totali	Shpenzime kapitale								
Totali (korrente+ kapitale)		336,580	416,657	416,657	625,159	466,906	239,306	-75,753	
Drejtuesi I Ekipit	Enri	Kryetari I Njesisë Vetëqeverisjes Vendore	Emri						
Tenaxhues t									
Programit									
				Firma		Firma			
	Data		Data						

Bashkia	Vlore						Kodi i grupit/Njesise vendore	146001	
Programi	Arsimi I mesem						Kodi I programit	9230	
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2022	2 .PBA Plan Viti 2023	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2023	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2023	5.Buxheti vjetor Plan I peroidhes/prog resiv	6. Fakti I periudhës/progr esiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
600	Paga	29,112	29,713	29,713	32,674	23,869	20,450	-3,419	
601	Sigurime shoqërore	4,183	4,861	4,861	5,354	3,953	3,328	-625	
602	Mallra dhe shërbime të tjera								
603	Subvencione								
604	Transferta korrente të brendshme								
605	Transferta korrente të huaja								
606	Trans për buxh. fam & individ								
609									
651									
166									
Nëntotali	Shpenzime korrente								
230	Kapitale të patrupëzuara								
231	Kapitale të trupëzuara								
232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm								
230	Kapitale të patrupëzuara								
231	Kapitale të trupëzuara								
232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj								
Totali	Shpenzime kapitale								
Totali (korrente+ kapitale)		33,295	34,574	34,574	38,028	27,822	23,778	-4,044	
Drejtuesi I Ekipit	Enri	Kryetari I Njesisë Vetëqeverisjes Vendore	Emri						
Tenaxhues t									
Programit									
				Firma		Firma			
	Data		Data						

Bashkia	Vlore						Kodi i grupit/Njesise vendore	146001
Programi	Arsimi i mesem/Konviktet						Kodi i programit	9230
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2022	2 .PBA Plan Viti 2023	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2023	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2023	5.Buxheti vjetor Plan I periodes/progresiv	6. Fakti I periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	3,145	11,444	11,444	11,444	7,820	5,134	-2,686
601	Sigurime shoqërore	1,186	1,911	1,911	1,911	1,540	977	-563
602	Mallra dhe shërbime të tjera	9,118	13,468	13,468	17,468	14,362	847	-13,515
603	Subvencione							
604	Transferta korrente të brendshme							
605	Transferta korrente të huaja							
606	Trans për buxh. fam & individ	260						0
609								
651								
166								
Nëntotali	Shpenzime korrente							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara				27,338	27,338		-27,338
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							
Totali	Shpenzime kapitale							
	Totali (korrente+ kapitale)	13,709	26,823	26,823	58,161	51,060	6,958	-44,102
Drejtuesi I Ekipit	Emri	Kryetari i Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri				
Menaxhuesi i Programit	Firma			Firma				
	Data			Data				

Bashkia	Vlore						Kodi i grupit/Njesise vendore	146001
Programi	Qendra PAK						Kodi i programit	10430
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2022	2 .PBA Plan Viti 2023	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2023	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2023	5.Buxheti vjetor Plan I periodes/progresiv	6. Fakti I periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	2,231	9,246	9,246	9,246	6,550	4,802	-1,748
601	Sigurime shoqërore	330	1,470	1,470	1,470	1,170	800	-370
602	Mallra dhe shërbime të tjera	4,295	4,610	4,610	4,610	2,960	1,414	-1,546
603	Subvencione							
604	Transferta korrente të brendshme							
605	Transferta korrente të huaja							
606	Trans për buxh. fam & individ	177						0
609								
651								
166								
Nëntotali	Shpenzime korrente							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara	1,841	2,000	2,000	2,000	2,000	1,021	-979
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							
Totali	Shpenzime kapitale							
	Totali (korrente+ kapitale)	8,874	17,326	17,326	17,326	12,680	8,037	-4,643
Drejtuesi I Ekipit	Emri	Kryetari i Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri				
Menaxhuesi i Programit	Firma			Firma				
	Data			Data				

Bashkia	Vlore							Kodi i grupit/Njesise vendore	146001
Programi	Shtepia e Femijes							Kodi I programit	10430
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2022	2 .PBA Plan Viti 2023	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2023	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2023	5.Buxheti vjetor Plan I peroidhes/progresiv	6. Fakti I periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
600	Paga	5,329	7,530	7,530	7,530	5,060	4,127	-933	
601	Sigurime shoqërore	872	1,257	1,257	1,257	820	684	-136	
602	Mallra dhe shërbime të tjer	1,584	2,000	2,000	2,000	1,050	689	-361	
603	Subvencione								
604	Transferta korrente të brendshme								
605	Transferta korrente të huaja								
606	Trans për buxh. fam & indivi	150						0	
609									
651									
166									
Nëntotali	Shpenzime korrente								
230	Kapitale të patrupëzuara								
231	Kapitale të trupëzuara								
232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm								
230	Kapitale të patrupëzuara								
231	Kapitale të trupëzuara	311	770	770	770	770	70	-700	
232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj								
Totali	Shpenzime kapitale								
	Totali (korrente+ kapitale)	8,246	11,557	11,557	11,557	7,700	5,570	-2,130	
Drejtuesi I Ekipit	Emri	Kryetari I Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri					
Menaxhues t									
Programit									
	Firma			Firma					
	Data			Data					

Nga tabelat e paraqitura më lartë në një vlerësim të përgjithshëm konstatohet se ka një mos realizim të shpenzimeve të planifikuara për periudhën e 8 mujorit të parë, përse i përket shpenzimeve sipas programeve ashtu edhe sipas artikujve. Ky mos realizim është në një masë të konsiderueshme kryesisht është në artikullin 231 (investime) sikurse paraqitet në tabelë si dhe lista analitike si me poshte:

Lista e Investimeve te Ralizura 1 Janar2023 -31 Gusht 2023

Nr	Emertimi I Investimit	Shuma
1	Ujesjellesi Transballkanike	38,000,000
2	Shpronisim Stefan Lefteri	1,962,542
3	Shpronisim Alfred Rrapi	2,289,630
4	Shpronisim Ilmi Cobani	582,636
5	Rikontruksion Shkolla Muco Delo	9,515,500
6	Shpronisim Antoneta Lula	4,777,869
7	Shpronisim Albana Cela	10,212,586
8	Shpronisim familja Xholi	2,366,838

9	Shpronesim Fuat Metushi	934,864
10	Rikonstruksioni I rruges Kerkove	21,600,000
11	Rikonstruksion I Murit Mbajtes se Karabashit	85,200
12	Ndertimi I struktures Pilot mbas Bashkise	6,047,616
13	Rikonstruksion I Bllokut Cameria	3,353,703
14	Asfaltim I Qytetit	28,594,230
15	Paisjee zyresh	230,841
16	Projekti Sumo	1,999,406
17	Shpronesim Katerina Xhorxhakaqis	312,998
18	Shpronesim familja Mecani	1,761,000
19	SHPRONESIM PER NATASHA LIKAJ	880561
20	SHPRONESIM PER FAMILJEN SKENDERAJ	4402806
21	AVDULI SHPK RIKONSTRUKSIONII I BLOKUT TE KUFIZUAR NGA BULEVARDI CAMERIA	1,004,985
22	Projekti Invalor	11429226
	Rrethimi I Varrezave Oriku	864000
	Shuma I (Basahkia)	153,209,037
19	Institucionet	25,064,999
	Shuma II (institucionet)	25,064,999
	Totali 8 Mujor	178,274,036

Sqarojmë se në mos realizimin e investimeve ndikim ka pasur vecanërisht miratimi me vonesë i buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2023, e cila ndikoi në kryerjen me vonesë të procedurave të prokurimit për realizimin e projekteve të planifikuara. Një faktor tjetër që ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve për investimet është edhe fakti që megjithëse projektet janë prokuruar nuk ka janë depozituar situacionet e punimeve për likuidim pasi janë në proces punimesh. Thëksojmë gjithashtu se plani i shpenzimeve për 8 mujorin e parë përfshinë gjithë fondet e trashëguara nga viti 2022 të cilat u çelën si shumë e përgjithshme me qëllim vijimin normal të procedurave të likuidimit të faturave duke qënë se këto fonde ishin të garantuara. Kjo konfirmohet në se bëjmë krahasimin ndërmjet planifikimit të buxhetit vjetor dhe atij tetë mujor

Treguesit e realizimit të Buxhetit të Shtetit (Fonde të Kushtëzuara)

kap.	EMERTIMI	TOTALI			600			601			602			604		606		231		
		Plan	Limit	Fakt	Plan	Limit	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Limit	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Limit	Fakt	Plan	Limit	Fakt
1170	Gjendja Civile	13,672,736	12,699,536	10,515,626	11,100,000	12,026,800	8,519,882	1,900,000	1,424,794	672,736	672,736	570,950				0				
1170	Shperblim lindje	0	0	0												0				
10430	Invalidet	533,873,000	588,380,524	409,925,072								588,380,524			533,873,000	409,925,072				
10430		0	0	0																
10430	Ndihma ekonomike	48,229,000	0	36,141,053										48,229,000	36,141,053					
10430	Qendra e shendetit	6,278,524	0	4,672,583										6,278,524	4,672,583					
9240	Arsimi profesional	0	0	0						0										
4130	Q.K.R	22,000	22,000	0		22,000	0	22,000	0			0				0				
9240	Bursat	9,424,380	9,672,513	7,568,760						1,630,000	9,672,513	0		7,794,380	7,568,760					
9120	Arsimi 9 vjecar	29,046,941	27,690,553	6,493,660						11,269,940	9,913,552	6,493,660					17,777,001	17,777,001	0	
9230	Arsimi i mesem	2,762,500	0	2,762,500						2,762,500		2,762,500								0
6180	Shpronisimet	20,000,000	20,000,000														20,000,000	20,000,000	0	
6370	Investime	138,000,000	137,500,000	38,000,000													138,000,000	137,500,000	38,000,000	
6260	Zhvillimi	0	0	0																0
6220	Fzhr	0	0	0																0
6220	Fzhr	0	0	0																0
0		25,294,994		1,651,536										25,294,994	1,651,536					
6190	Min financave	1,093,910	546,955	0												546,955	0	546,955	546,955	0
4240	Ujitja dhe kullimi	0	0	0																0
1620	Zejedhjet	8,210,000	8,210,000	6,867,275	7,236,500	7,236,500	6,061,775			973,500	973,500	805,500								0
4520	Shpronisimet	0	0	0																0
6180	Shpronisimet	0	0	0																0
	TOTALI	835,907,985	804,722,081	524,598,065	11,100,000	12,048,800	8,519,882	1,922,000	1,424,794	16,335,176	598,966,812	9,256,160	25,294,994	1,651,536	596,174,904	458,307,468	158,546,955	158,046,955	38,000,000	

Realizimi total i buxhetit të shtetit gjatë periudhës janar-gusht 2023siç paraqitet dhe në pasqyrën e mësipërme është 66%.nga të cilat:

Fondi i pagave rezulton 76.7%

Fondi i sigurimeve shoqërore rezulton 74%

Fondi i shpenzimeve operative rezulton 56.6%

Fondi i ndihmave dhe përkrahjeve rezulton 76.8%

Fondi i investimeve rezulton 23.9%

ANALIZA E SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

1. Projekti : Planifikim, Menaxhim dhe administrim

Programi : K01110 - Administrim, Menaxhim, Planifikim

Funksioni : Administrata Vendore

- **Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve**

Gjatë 8 muajve kalendarik Janar- Gusht 2023, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Vlorë, ka kryer procedurat e mëposhtme administrative:

1. Në zbatim të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, ka kryer plotësimet ligjore te kerkuara mbi procedurat e shpronësimit të subjekteve pronar të cilët preken nga realizimi i

projekteve për interes publik duke përcjellë pranë Agjensisë Shtetërore të Shpronësimit kërkesën për shpronësimi për pasuritë e paluajtshme të cilat prekeshin nga projekti i shpronësimit “ Lidhja e rrugës së Portit me Rrugën Transballkanike”. Jemi ne pritje të publikimit të VKM-së së shpronësimit për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të likujdimit për subjektet e shpronësuar, pjesë e kësaj VKM-je.

2. Përsa i përket procedurave të likujdimit të cilat realizohen nga Bashkia Vlorë konkretisht për projektin e Ballinës Ujore dhe projektin e Landfillit të Sherishtës ju sqarojmë se: Nga Buxheti i Shtetit është akorduar 43,400,000 lekë si fond për shpronësimin dhe likujdimin e vlerës së shpronësimit të subjekteve të cilët preken nga realizimi i projektit “Ballina Ujore e Qytetit të Vlorës”. Nga shuma e mësipërme vlera e likujdimit deri në 31.12.2021 është 28,685,161 lekë, pra ngelet një diferencë prej 14,714,839 lekë të cilat si fonde të Buxhetit të Shtetit rezultojnë të djegura për arsye se subjektet e tjera të cilët janë në VKM-në e shpronësimit nuk kanë paraqitur dokumentacionin ligjor për likujdim ose nuk e kanë plotësuar këtë të fundit. Kurse përsa i përket vlerës së shpronësimit për projektin e landfillit të Sherishtës ju sqarojmë se nga Buxheti i Shtetit për procedurën e likujdimit të subjekteve të shpronësuar është akorduar fondi në vlerë 29,442,300 lekë, ku është përdorur vetëm 14,664,690 lekë për likujdimin e subjekteve të shpronësuar ndërsa vlera prej 14,777,610 lekë është djegur nga ky fond për arsye se subjektet e tjera të shpronësuar nuk kanë dorëzuar dhe plotësuar dokumentacionin ligjor për marrjen e masës shpërblimit të shpronësimit. Këtë informacion DPPMA do t’ia vendosë në dispozicion dhe Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit për të kryer procedurat e mëtejshme ligjore për riçeljen e fondeve të mbetura të shpronësimit për subjektet pronar të pashpronësuar.

3. Ka kryer procedurën e përcjelljes së dosjeve të subjekteve përfituese më tokë bujqësorë në pronësi/përdorim sipas dispozitave ligjore në fuqi të ligjit 20/2020 pranë ASHK-së Vlorë. Pasi dosjet përgatiten dhe plotësohen nga përfituesit e tokave bujqësore në pronësi/përdorim, në Njësitë përkatëse administrative. Këto të fundit me plotësimin e plotë të dosjeve me dokumentacionin tekniko- ligjor e përcjellin pranë DPPMA-së Bashkia Vlorë. Në vijim të kësaj korrespondence këto praktika që plotësojnë kërkesat sipas ligjit dërgohen në ASHK- në Vendore Vlorë për regjistrimin e AMTP-së dhe pajisjes me certifikatë pronësie. Gjithashtu në vijim të regjistrimit të AMTP-ve DPPMA, e Bashkisë Vlorë kryen korrespondencën me ASHK-në Vendore për plotësimin e këtyre praktikave si shpallje përditësime etj, kërkesa këto sipas ligjit.

4. Përsa i përket procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësorë nga përdorimi në pronësi sipas ligjit 20/2020 dhe VKM-së Nr.1182 të vitit 2020, janë dërguar praktikat e depozituara nga fermerët në Njësitë Administrative dhe në Zyrën e Bujqësisë, pranë DPPMA. Praktika të cilat janë përcjellë në ASHK-në Vendore Vlorë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave sipas përcaktimeve ligjore.

5. Ka përgatitur materialet dhe i ka referuar në Këshillin Bashkiak 15 praktika për kalimin nga përdorimi në pronësi të subjektëve faktik të tokave bujqësorë mbi bazën e dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja Vendore.

6. Ka kryer korrespondencën me qytetarët brenda afateve të caktuara kohore në lidhje me objekt ankesat e dërguara me shkrim ose në mënyrë elektronike.
7. Ka zhvilluar korrespondencën me institucionet e ndryshme vendore dhe qendrore në lidhje me shpronësimet dhe inventarët e pasurive të paluajtshme.
8. Ka vijuar me procedurën e likuidimit të subjekteve të shpronësuar me VKM-të e shpronësimit të viteve të mëparshme. Duke zhvilluar korrespondencën me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjensinë Shtetërore të Shpronësimit.
9. Ka arkëtuar të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirave publike si stacione plazhi nga subjektet private mbas miratimit në parim që marrin nga GTSHA pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Në lidhje me nivelin e të ardhura ju konfirmojmë që për vitin 2023 deri në datë.31.08.2023 janë grumbulluar 41,167,760 lekë, ndërkohë që parashikimi për vitin 2023 në paketën fiskale për të ardhurat që do të grumbulloheshin nga shfrytëzimi i hapësirës publike plazh ishte 38.000.000. Pra, shihet qartë që niveli i të ardhuravë të grumbulluara është realizuar dhe është tejkaluar për vitin 2023.
10. Në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore ka lidhur akt-marrevëshjet për shfrytëzimin e hapësirave publike pas depozitimit të dokumentacionit në DAV nga subjektet aplikues. Pasi DAV verifikon dokumencionin përgatit aktmarrëveshjet së bashku me DPPMA-në.
11. Ka ndjekur procedurat gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës Vlorë dhe Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në cilësin e palës së paditur për çështjet gjyqësore me objekt ndryshimin e vlerës së shpronësimit, proceseve të cilat janë iniciuar nga subjektet e shpronësuar.

- **Drejtoria Juridike**

Drejtoria juridike përkatësisht specialistët e saj sikurse ka proceduar në vijmësi edhe në periudhën e vitit Janar 2023-Gusht 2023 është përqëndruar në realizimin e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Organizimit dhe të Funksionimit të Administratës së Bashkisë. Gjithashtu është angazhuar edhe në zgjidhjen e problematikave që dalin gjatë praktikës së përditshme të punës qoftë të Drejtorisë por edhe në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të Bashkisë.

Gjatë kësaj periudhe 8 mujore janë përgatitur akte administrative si Vendime për vendimarrje të Këshillit të Bashkisë si dhe Vendime ose Urdhëra sipas rastit të Kryetarit të Bashkisë të cilat kanë qënë të lidhura vecanërisht me Drejtorinë Juridike. Gjithashtu është

verifikuar ligjshmëria dhe janë sigluar akte administrative të përpiluara nga Drejtoritë dhe zyrat e tjera të Bashkisë ose Institucionet e tjera të varësise. Për të gjitha këto akte referuar argumentimit ligjor është konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë.

Konkretisht referuar të dhënave në mënyrë të koncentruar theksojmë se gjate periudhës 8 mujore nga specialistët e Drejtorisë Juridike janë pregatitur rreth 20 Projekt- Vendime për Vendimarrje të Këshillit të Bashkisë, objekti i të cilave është i lidhur drejtëpërdrejt me Drejtorinë Juridike ose iniciuar prej saj, gjithashtu janë asistuar nëpërmjet konsulencës ligjore përafërsisht 15 Projekt-vendime për Këshillin e Bashkisë.

Janë përgatitur gjithashtu dhjetëra urdhëra dhe vendime të Kryetarit të Bashkisë për problematika të ndryshme të cilat lidhen me Drejtorin dhe sektorë të tjerë të Bashkisë si dhe rregullore të ndryshme në funksion të realizimit të procedurave të veprimtarisë së administratës së Bashkisë

Gjithashtu në bashkëpunim me Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve është përpunuar dokumentacioni për shpronësimin e pasurive pronë private për projekte në infrastrukturë si projekti “Rigjenerim Urban i Shëtitorës Bregdetare Qëndrore të Vlorës Sheshit “Isa Boletini dhe Portit”, procedura për sistemimin e sheshit të Flamurit etj të cilat kërkonin vendimarrje të këshillit të bashkisë.

B) me autorizimin e Kryetarit të Bashkisë nga specialistët e Drejtorisë Juridike është përfaqësuar bashkia Vlorë dhe institucionet e varësisë së saj në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit në cilat është thirrur si palë e paditur si dhe janë pregatitur kërkesë paditë kur vet bashkia Vlorë ka iniciuar proceset gjyqësore vecanërisht në zbatim të detyrave të lëna

nga KLSH ose Institucione të tjera të Auditimit. Gjatë vitit 2023 kanë nisur procedurat gjyqësoret për 160 çështje kryesisht të inicuar nga palët e treta kundër bashkisë Vlorë ose Institucioneve në varësi të saj të cilat janë ndjekur rregullisht nga specialistet e drejtorisë juridike. Gjithashtu janë mbi 100 çështje të tjera gjyqësore në vijim nga vitet e kaluara në shkallë të ndryshme të gjyqësorit të cilat datojnë që prej vitit 2009. Edhe keto procese gjyqësore janë ndjekur rregullisht nga Drejtoria Juridike.

Sikurse trajtuam vec çështjeve të filluara gjatë këtij viti janë ndjekur nga Drejtoria Juridike të viteve të kaluara shumë çështje të cilat janë duke u shqyrtuar nga Gjykata Civile e Apelit dhe Gjykata Administrative e Apelit ose Gjykata e Lartë që presin të shqyrtohen si dhe çështje që pasi janë ankimuar janë risjellë përsëri për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Civile ose Administrative.

Mund të themi se Drejtoria Juridike i ka ndjekur me përgjegjësi gjithë seancat gjyqësore dhe shkallët e gjyqimit me qëllim mbrojtjen e interesave të Bashkisë. Në asnjë rast nuk është konstatuar neglizhenca e specialistëve të Drejtorisë Juridike të Bashkisë në ndjekjen e procedurave gjyqësore.

Fakti që theksuam më lart sipas të cilit shumë çështje janë në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë si dhe shumë çështje janë ankimuar ose janë kthyer për rigjykim mbi bazën e ankimit të Bashkisë dhe vazhdojnë prej shume vitesh për një vendim përfundimtar e konfirmon këtë konstatim. Duhet të theksojmë se nuk ka çështje gjyqësore të cilat janë për të kundërshtuar akte të drejtpërdrejta të organeve vendimarrëse të Bashkisë dhe të kenë sjellë pasoja financiare për Bashkinë Vlorë.

Objekt i çështjeve gjyqësore ka qënë lidhur me problematika të ndryshme si kundërshtim vlere shpronësimi nga projektet e shumta në infrastrukturë, leje ndërtimi, marrëdhënie pune, shlyerje detyrimesh për procedurat tatimore etj. Nga këto më të vështira për tu mbrojtur kanë qënë çështjet e vlerës së shpronësimit të pasurive pronë private të prekura nga projektet në Infrastrukturën Publike si dhe marrëdhëniet e punës.

Kjo pasi gjatë procedurës së shpronësimit llogaritja e vlerave përkatëse është bërë sipas cmimeve të references bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ndërkohë që nga pronarët pasuritë e të cilëve janë shpronësuar është kërkuar nëpërmjet gjykatës llogaritja e vlerës sipas cmimeve të tregut. Mund të themi se ka pasur raste që gjykatat kanë pranuar paditë pavarësisht pretendimeve tona. Theksojmë se në procedurat e shpronësimit Bashkia ka kryer vetëm vlerësimin paraprak pasi vendimi përfundimtar është i Ministrisë përkatëse.

Theksojmë se Vendimet e Gjykatës me detyrime financiare për Bashkinë janë në tërësi

vendime të Gjykatës së Apelit pasi në çdo rast vendimet e Gjykatës së shkallës së Parë janë ankimuar.

C) Gjithashtu rëndësi e veçantë i është kushtuar korespondences me Institucionet e tjera shtetërore si dhe përgjigjet mbi kërkesat dhe ankesat e qytetarëve drejtuar Bashkisë të cilat kanë pasur lidhje me Drejtorinë Juridike si dhe atyre në platformën “Shqipëria që Duam”. Në punën e Drejtorisë Juridike vëmendje të veçantë ka pasur korrespondenca dhe komunikimi me Institucione të tjera shtetërore dhe përgjigjeve për kërkesat e qytetarëve sipas problematikës për të cilën është adresuar për zgjidhje Drejtoria Juridike. Në të gjitha rastet përgjigja ka qenë e përgjegjshme bazuar dhe në dispozitat ligjore në fuqi si dhe brënda afateve të parashikuara në ligjin “Për të drejtën e informimit”.

Mund të themi se nga mbi 200 kërkesa dhe ankesa të adresuara Drejtorisë Juridike gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur çështje të pasqaruara për të cilat qytetarët t’i jenë drejtuar gjykatës ose organeve të tjera shtetërore në lidhje me Bashkinë Vlorë pasi kanë komunikuar direkt me Drejtorinë Juridike . Gjithashtu i është dhënë përgjigje në kohë cdo çështjeje që lidhet me Drejtorinë Juridike portalit të bashkëqeverisjes si dhe është bashkëpunuar me Drejtorinë, Sektorët si dhe institucionet e tjera të varësisë për përgjigjet e ankesave drejtuar këtij portali. Në përgjigjen e dhënë qytetarëve për kërkesat e tyre është zbatuar sikurse theksuam më lartë procedura e parashikuar në ligjin ”Për të drejtën e informimit”.

Vec përgjigjeve për kërkesa dhe ankesa janë pajisur qytetarët mesatarisht çdo ditë rreth 5 deri në 10 vërtetime ose konfirmime të ndryshme sipas problematikës së paraqitur prej tyre. Në raste të tilla është synuar të pajisen në çast edhe pse afatet mund të ishin disa ditore.

Theksojmë se puna ditore e specialistëve të Drejtorisë Juridike është kryer në bashkëpunim, edhe me Drejtorin të tjera për plotësimin e dokumentacionit shkresor sipas problematikës së krijuar rast pas rasti.

D)Gjithashtu një çështje që vlen për tu theksuar është angazhimi i tërë specialistëve të Drejtorisë Juridike lidhur me ndjekjen e çështjes gjyqësore “Duka”shpk kundrejt Bashkisë Vlorë si edhe përgatitjen e materialit në lidhjen me problematiken e hasur gjatë zbatimit të kontratës për pastrimin e qytetit të Vlorës nga kjo shoqëri.

Pavarësisht sa parashtruam më lart, mendojmë se bashkëveprimi i Drejtorive, sektorëve edhe Njësive Administrative në Bashki do të ndikojë që të ketë sa më pak kundërshtime të Akteve

Administrative të Bashkisë Vlorë, të cilat shpesh ndodhin nga paqartësitë më shumë se nga përmbajtja e tyre.

Vecanërisht duhet të theksojmë se respektimi i afateve të përcaktuara ligjore për procedurat vendimmarrëse si dhe arsytimi për çdo vendimarrje të organeve vendimmarrëse do të ndikojë në evitimin e rasteve për të cilat palët e interesuara i drejtohen Gjykatës.

Konkretisht kjo veçanërisht është e domosdoshme për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, procedurat e hartimit dhe zbatimit të projekteve në infrastrukturë si dhe procedurat e shpronësimit. E theksojmë këtë pasi gjykata i kushton rëndësi të veçantë ndjekjes së procedurave administrative për çdo vendimarrje të organeve kompetente shtetërore në rastin e qeverisjes vendore të Kryetarit dhe Këshillit të Bashkisë. Nisur nga problematika e konstatuar në praktikën e mëparshme si dhe gjatë vitit 2023 e vlerësojmë të nevojshme që para çdo vendimarrje të bashkëpunohet me specialistët e Drejtorise Juridike.

• **Drejtoria e Urbanistikës**

Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Vlorë, prej periudhës Janar-Gusht 2023 ka kryer punën si më poshtë vijon:

1. Sistemi e-Lejet

Gjatë periudhës Janar – Gusht të vitit 2023 , në sistemin elektronik e-Lejet rezultojnë **777** aplikime për leje ndertimi nga të cilat:

- Të përfunduara **657** leje (ka përfunduar shqyrtimi i tyre nga specialistet përkatës në këtë sektor).
- Në proces **120** leje.

2. Të ardhura nga Taksa e Infrastrukturës

Gjate punes ne sektorin e kontrollit te lejeve te ndertimit, eshte bere e mundur arketimi i vleres 147221398.8lekë si takse e ndikimit ne infrastrukture per cdo leje ndertimi te miratuar:
Ku përfshihen llojet e lejeve si më poshtë:

- Çertifikatë Përdorimi
- Deklarat paraprake
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250m²
- Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250m²
- Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250m²
- Leje për ndryshim aktiviteti/funksioni
- Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit
- Deklarata paraprake janar-prill të ardhura nga 3%

3. Projektet

Janë përfunduar këto projekte:

- **RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLES 9 VJECARE AVNI RUSTEMI**

Vlera = 64,393,660.09 leke

- Rikonstruksion dhe shtesë anësore 3 kate e shkollës 9 -vjeçare "Lef Sallata", Vlera = 87,780,000 lekë

- Rikualifikim i blokut Lef Sallata kufizuar nga rruget: "Bulevardi Ismail Qemali", "Veledin Kollozi", "Pilo Begaj", "Hajredin Haxhiraj" ,

Vlera = 200,914,375.30 lekë

- Rikualifikimi urban pranë Fabrikes se Cimentos, Vlore

Vlera = 351 milion leke

- Sistemimi i disa akseve te qytetit-asfaltime, Vlera = 9 milion leke

- Rikonstruksioni i salles One Stop Shop, Vlera = 8,942,547 leke

- Rikonstruksion i rruges ne fshatin Bestrove, Vlera = 56 milion leke

- Rehabilitim i rruges Demokracia-Orikum,Vlore, Vlera = 8 milion leke

- Rehabilitim i rruges se fshatit Skrofotine,Vlore, Vlera = 4.5 milion leke

- Rehabilitim i rruges se fshatit Radhime,Vlore, Vlera = 6 milion leke

- Rehabilitimi i interseksionit rrugor te rruges Dhimiter Konomi, vlera 3 milion leke

- Sistemimi i bllokut te banesave prane Big market, vlera 2.5 milion leke
- Sistemim territori blloku “28 Nentori”, vlera 2.5 milion leke
- Rruga e Fshatit Grabian, vlera 6 milion leke
- Rruga e varrezave fshati Risili, 2.5 milion leke
- Rikonstruksioni i rruges Bektash Cakrani, vlera 2.8 milion leke

4.Janë në proces këto projekte:

- Sistemi i disa hapsirave te gjelberta ne qytetin e Vlores (kende lojrash)
- Rikonstruksioni i bllokut te banimit ne lagjen Pus Mezini
- Rikonstruksioni i brendshem i palestres se qytetit
- Rikonstruksioni i disa kopshteve dhe cerdhe ne qytetin e Vlores
- Rikonstruksion i fasadave te objekteve te banimit ndertuar perpara viteve 90’

5.Hartimi i PDV-ve

Gjate periudhës Janar-Gusht, sektori i Planifikimit te Territorit ka përfunduar dhe ka në proces përpunimin e Planeve te Detajuara Vendore sipas njësave strukturore si më poshtë:

- VL.UB.15.948
- VL.UB.4.1058
- VL.UB.1.1333

6.Korrespondenca shkresore

Në bazë të Ligjit Nr.119/2014 “ Për të drejtën e informimit”, Drejtoria e Urbanistikës realizuar një numër mesatar javor informimi prej **65 qytetar/javë, përafërsisht 260 qytetarë të informuar në muaj.**

Gjate periudhes janar-gusht prane Drejtorise se Urbanistikës janë administruar dhe trajtuar **740** shkresa nga institucione, qytetarë dhe subjekte fizike dhe juridike.

7.Sistemi i adresave(Adresari)

Gjate muajve Janar-Gusht jane paraqitur mesatarisht 22 qytetare ne dite, duke perfshire edhe disa qytetare qe i perkasin njesive administrative te Bashkise Vlore. U eshte ofruar sherbimi per saktesim adrese apo konfirmim adrese per ndryshim vendbanimi. Gjithashtu ne bashkepunim te vazhdueshem me Gjendjen Civile nderhyjme ne rregullimin e pasaktesive ne Sistemin e Adresarit.

• **Policia Bashkiake**

Aktiviteti i Policisë Bashkiake është zhvilluar bazuar në Ligjin e ri për Policinë Bashkiake, Vendimeve të Këshillit Bashkiak si dhe urdhërave dhe udhëzimeve të Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

Problematika që parashikon ligji dhe praktika e punës e Policisë Bashkiake kanë një diapazon të gjerë dhe shpesh tejkalojnë parashikimet e mësipërme .

Me fillimin e vitit të ri është përgatitur dhe miratuar PLAN – VENDOSJA e Policisë Bashkiake Vlorë , është përgatitur dhe miratuar planizimi vjetor dhe mujor sipas specifikave të ndryshme .

- **Per Plazhet**

Ne zbatim te Planit te masave te Bashkise Vlore , “Per kontrollin dhe monitorimin e hapësirave publike dhe private si stacion plazhi” Nr 4883. Prot date 25.04.2023 , Urdherit te Brendeshem te Kryetarit te Bashkise Nr 127 date 25.04.2023 , “ Per kontrollin e hapësirave publike si Stacion Plazhi ” , Policia Bashkiake mori ne monitorim te gjithe vijen bregdetare ne territorin e Bashkise Vlore , duke e ndare ate ne pese sektor dhe duke e mbuluar me kontrole te perditeshme gjithe territorin.

Konkretisht : Sektori Hidrovor (Akerni) , kane ushtruar aktivitet 3 stacione plazhi.

Sektori Hunde Plakut (Zverrnek)- Plazhi I Vjeter , kane ushtruar aktivitet 61 stacione plazhi .

Sektori Lungomare – Jonufer , kane ushtruar aktivitet 62 stacione plazhi .

Sektori Jonufer - Moli Bacit (Radhime),kane ushtruar aktivitet 51 stacione plazhi.

Sektori Moli Bacit – Postoblloku Pashalimanit , kane ushtruar aktivitet 51 stacione plazhi.

Gjithsej pergjate gjithe vijes bregdetare ne territorin e Bashkise Vlore kane ushtruar aktivitetin 228 stacione plazhi.

Qysh prej fillimit te aktivitetit ne keto stacione eshte vrejtur munges ne plotsimin e kushteve te sigurise te parashikuara ne VKM nr 171 date 27.03.2019 . Ne stacione te shumte mungonte vrojtuesi i plazhit , edhe pse i deklaruar ne aplikimet e bera nga subjektet per marrjen e lejes stacion plazhi , jo ne pak raste ky aplikim ka qene fiktiv , (vrojtues te deklaruar ne stacione plazhi ne nje distanc te konsiderueshme nga njeri tjetri).

Jane kostatuar mungesa te Kullave (pikave) te vrojtimit apo kompletimi i tyre, mungesa e vendosjes se tapave kufizues . Per cdo raste te kostatuar sherbimet e Policise Bashkiake kane nderhyre duke bere bllokimin e aktivitetit stacion plazhi deri ne plotsimin e kushteve te sigurise e shoqeruar me dokumentacionin perkates ne 42 raste . Per rastet e rikostatuara ne zbatim te VKB ,Nr 76 date 30.09.2022 eshte marre masa administrative gjobe (20000 leke) ne 10 raste .

Vete apo ne bashkpunim me Task Forcen e Prefektures , ARB , Policine e Shtetit eshte nderhyre ne lirimin e hapsirave te percaktuara si plazh publik sidomos ne zonen e Lungomares , Zvernec dhe Orikum ne 15 raste.

Bashkepunimi midis te gjitha strukturave qe kane qene te angazhuar ne mbarvajtjen e sezonit turistik ka bere qe ne vijen bregdetare te Bashkise Vlore te mos kete asnje ngjarje te jashtezakonshme (mbytje) .

- Ne fushen e mjedisit

Policia Bashkiake eshte e angazhuar me sherbim 24 ore per evidentimin e zjarreve te qellimshme, apo ne riaktivizimin e tyre ne pikën e grumbullimit te mbetjeve urbane , ku dihet veshtiresia pasi sipërfaqja e pikës së grumbullimit të mbetjeve është e madhe e pa rrethuar. Jo ne pake raste eshte kostatuar aktivizimi i shume vatrave te zjarrit deri dhe ne raste ekstreme ku eshte punuar nga te gjitha strukturat per fikjen e tij .

Vemendje te shtuar Policia Bashkiake sidomos pergjat sezonit turistik ka pasur ndaj subjekteve apo individëve që hedhim mbetje jashtë koshave te mbetjeve urbane , duke u bere nje shqetsim i vazhdueshem per komunitetin dhe sherbimet e pastrimit .Per kete ne zonat me prioritet turistik ku dhe rrisku i keti fenomeni eshte me i larte kontrollet e sherbimeve te Policise Bashkiake kane qene pergjat 24 oreve duke u ndare ne grupe pune se bashku me strukturat e tjera te Bashkise . Ndaj rasteve te kostatuar per subjekte dhe qytetare te ndryshem jane marrë rreth 20 masa administrative.

Janë marrë 10 masa administrative ndaj subjekteve dhe individëve për zënien e hapsirave publike (tortuar , lulishte) nga biznese te ndryshme apo tregetare ambulant .

Muzika e larte sidomos nga bizneset qe operojne ne zonen bregdetare ka qene nje nga prioritet e Policise Bashkiake pergjate sezonit turistik . Vet apo ne bashkpunim me Policine e Shteti , ARM , Task Forcen e Prefektures kemi ushtruar kontrolle sidomos ne fundjave .Nje problematik e hasur per vlersimin e ndotjes akustike eshte mungesa e nje paisje matese . Aktalisht ne gjithë qarkun e Vlores nje paisje te tille dhe specialistet perkates e ka vetem ISHP i cili realizon matje ne te gjitha bashkite e qarkut .

- Hapsirat publike

Prioritet i punes sone ka qene dhe kontrolli i territorit te Bashkise sidomos shfrytezimi i hapsirave publike . Kontrolle te perditeshme vetem ose ne bashkpunim me Inspektoret e DAV kemi ushtruar kontrolle dhe per shkeljet e kostatuara kemi marre dhe masa administrative perkatese .

Po merr përmasa dhe është kthyer në shqetësim për pushuesit, zënia e hapësirave publike apo private , me parkime të pamiratuara me çmime sipas orekseve.Per te shmangur kete fenomen edhe pse eshte nderhyre ne bashkpunim me organet tatimore , Policine e Shtetit ku eshte bere dhe bllokim aktiviteti (Rasti Jonufres) rezultati nuk ka qene ai i duhuri Gjithashtu kontrole jane bere ne ruajtjen e hapësirave publike nga dëmtimet ,rrugëve,trortuareve dhe ndërtesave pronë e Bashkisë.

Çlirimi hapësirave publike të zëna nga tregtarët ambulant, nga subjektet që operojn në katet e paratë pallateve apo ndërtesa në rrugët kryesore të qytetit dhe njësive administrative etj.Eshtë ndërhyre nëmbi 170 raste.

- **Qarkullimi**

Nje problematik e perditeshme e qe ndiqet me prioritet nga Policia Bashkiake eshte dhe qarkullimi rrugor .Pergjate gjithe sezonit turistik dy efektiv kryejn sherbim te perditshem te rreth- rrotullimi ne skel ne vendkalimin e kembesoreve , si dhe tete efektiv te tjere kryejn sherbim ne Lungomare dhe ne Bulevard .

Nje prioritet I punes sone eshte ndalimi I levizjes se motorrave ne korsin e bicikletave .sidomos ne Lungomare dhe ne bulevard.

Nje veshtiresi ne drejtim te qarkullimit rrugor ka qene vjelja e gjobes e cila vilet kesh nga ana jone pasi gjobat e Policise Bashkiake nuk jane ne sistemin e Policise Shtetit (modeli I Policise Bashkiake Tirane) .

Kemi ushtruar kontrole të përditëshme dhe kemi marrë masa administrative per kamjonët që ndotin rrugët e qytetit apo hyjnë dhe dalin në vendgrumbullimin e mjeteve inerte duke i detyruar të pastrojnë rrugën.

Trafiku pranë shkollave është e pamundur të mbulohet vetëm nga Policia Bashkiake për shkak te numerit të kufizuar të efektivit por pranë shkollave që janë në rrugët kryesore shërbimet tona nuk kanë munguar .

- **Te ndryshme**

Janë zgjidh në kohë të gjitha ankesat e ardhura nga qytetarët , Policia e Shtetit si dhe Platforma e Bashkëqeverisjes në rreth 280 raste .

Eshtë ndërhyre vet apo në mbeshtetje të INUV, njësive administrative e rajoneve për parandalimin e ndërtimeve pa leje apo prishjen e tyre në 25 raste.

Janë ushtruar kontrole te përditshem vetëm apo në bashkpunim me inspektorët pyjeve dhe kullotave për evitimin e prerjeve të paligjëshme apo hedhjen e mbeturinave në Pyllin e Sodës, Llogora,ku sa herë që kushtet metreologjike kanë qenë me erë Policia Bashkiake ka bllokuar segmente rrugësh që paraqesnin rrezik nga pemët e rrëzuara sidomos ne Pyllin E Sodes.

Eshtë mbuluar me shërbim Tregu në Novoselë cdo ditë të enjte .

Eshte bere sigurimi I mbarvajtjes se aktiviteteve te ndryshme social kulturore qe ka organizuar Bashkia Vlore pergjat gjithë vitit ne jo me pake se 60 raste .

Eshte bere siguria e aktiviteteve sportive qe Klubi Sportiv “ FLAMURTARI ” dhe “ORIKU” kane zhvilluar sipas kalendarit sportive te tyre.

Sezoni turistik në vecanti si dhe shtrirja gjeografike e territorit të Bashkisë na detyron që tju kërkojmë rishikimin e organikes të Policisë Bashkiake në nivel drejtues dhe trupë policore pasi në jo pak raste ekemi tejet të veshtir të realizojm detyrat që na ngarkon ligji duke detyruar efektivin të punoj me orar teje të zgjatur dhe të pa paguar për realizimin e detyrave .

Policia Bashkiake është angazhuar në krijimin e kushteve optimale për punën që kryejnë firmat zbatuese të projekteve të shumta që kryhen në qytet .Gjithashtu kemi bashkëpunuar cdo ditë me drejtorit e Bashkise UK , NSHP , DIP, sipas kerkesës së tyre duke nderhyre ne largime mjeteshe qe behen pengese per punime , dhe bllokime segmentesh rrugore ne vartesi te proceseve te punimeve .

• **DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE**

A. SEKTORI I INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

1. Verifikimi i problematikave të qytetarëve dhe institucioneve te arsimit në terren
2. Korespondenca me ndërmarrjet dhe qytetarët
3. Hartimi i projekt - preventivit të tualeteve të shkollës “ Ismail Qemali”
4. Hartimi i projekt-preventivit të tualeteve të shkollës “ Jani Minga”
5. Verifikimi i problematikave të ngritura nga portali dhe kthimi i përgjigjeve.

B- SHERBIMI I PASTRIMIT TE QYTETIT

Pastrimi i qytetit te Vlores eshte kryer nga firma me siper marrje "Duka"shpk, e cila ka fituar tenderin per 3 vjet me nje fond prej 698 022 984 (gjashteqinde nentedhete etete milion e njezete e dy mije e nenteqind e tetedhete e kater)leke me tvsh, deri në dt.03.07.2023 dhe aktualisht realizohet nga Ndermarrja e Shërbimeve Publike. Nga ana e firmes janë kryer keto sherbime:

- 1.Fshirja e rrugeve,
- 2.Largim, transporti mbeturinave urbane
- 3.Larja e rrugeve me uje.
4. lag'je e rrugeve me uje

5. Sistemim ne fushen e grumbullimit
6. Larje e bulevardit me detergjent

Pastrimi i Njesise Administrative Orikum deri në 25.03.2023 është realizuar nga firma ne sipermarje “Bajtel” sh.p.k. qe ka fituar tenderin 3 – vjeçar me nje fond prej 78 941 978 (shtatedhete e tete mijon nenteqind e dyzet e nje mije e nente qind) leke me tvsh. Nga dt.03.07.2023 ky shërbim realizohet nga kompania “Silver”, e cila ka fituar tenderin 1-vjeçar për pastrimin e Njesisë Administrative Orikum

Nga ana e kompanise realizohen keto sherbime:

1. Largim transport mbeturinash
2. Fshirje e rrugeve
3. Larje e rrugeve
4. Sistemim mbeturinash

Pastrimi i Njesive Administrative Novoselë, Qendër dhe Shushicëderi në 30.04.2023 është realizuar nga firma ne sipermarje “Rej” sh.p.k. qe ka fituar tenderin 3 – vjeçar me nje fond prej 78 594 536 (shtatedhete e tete mijon peseqind e nëntëdhjetë e katër mije e pesë qind) leke me tvsh. Aktualisht ky shërbim po realiohet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Nga ana e kompanise realizohen keto sherbime:

1. Largim transport mbeturinash
2. Fshirje e shesheve kryesore

Per qytetin e Vlores, sherbimet e kryera jane:

Fshirja e rrugeve , trotuareve, shesheve dhe blloqeve te banimit kryhet 1 here ne 24 ore dhe 6 dite jave, ne oraret 11.00 - 07.00, ne nje sipërfaqe prej 557 910 m² me punetore dhe 188 042 m² me autofshesa. Gjithashtu rruget kryesore dhe me fluks te larte levizjeje fshihen edhe nje here gjate dites. Zbrazen koshat e vegjel ne shetitore dhe bulevard. Ky sherbim realizohet me punetore me fshesa .

Çdo dite hiqen 140t mbetje urbane e shperndara ne 850konteniere ne rreth 360 pika grumbullimi. Mbeturinathiqen 1 here ne 24 ore pas ores 22:00ne 7 ditetejaves. Gjatesezonitturistikmbeturinat urbane ne 90 pika ne zoneturistikelargohendy here ne dite, per temospasurkontenieretetejmbushur.Mbetjet e papranueshme (inerte, elektroshtepiake, krasitjekopshteshetj)

pranekonteniereveqeevidentohenedhengarajonet,qëduhettëlargohenngakompania e pastrimit, janëhequr me mjetet e NdërmarrjessëShërbimevePublike.Pranëfushëssëgrumbullimit, derinë fund tëmuajitqershor, kaqenë e instaluar peshorja e cilakapeshuartegjithambetjetqëdepozitoheshinnëfushën e grumbullimit.

Larja e rrugeveështërealizuar nje here ne 24 ore ne oraret 02:00 – 06:00(10 muaj)ngamarsi – dhjetor me aneteautobotevelares.

Lag’ja e rrugeverrealizohetmbasdite 16:00 – 18:00, përevitimin e pluhuritnërrugëdhëfreskiminmbasditegjatëverës.

Rendesi e veçanteieshtekushtuaredheedukimit publiknepermjet medias televizive e asajteshkuar ,fletepalosjedhepostera, per sensibilizimin e komunitetit per mbajtjenpasterteqytetit .

Gjateketij 8-mujori nukeshetenderpreresherbimidhepunët e pa kryerangakompania “Duka”shpk, derinë fund tëqershoritështëplotësuarngaNdërmarrja e ShërbimevePublike. Gjatemuajve mars – prilleshteshtuarkujdesi per larjen e rrugeve me detergjentdhedisifektimin e konteniereve.

Ne bashkepunim me bankengjermane KFËposhikojmemundesine e zevendesimittekonteniereve ,ndertimin e bazamentevedheimplementiminkontenierevetenendheshem ne nje zone pilot.

PROBLEME:

1. *Vendosja e koshave te vegjel ne lungomare dhe rruget kryesore te qytetit .*
2. *Hedhja e mbetjeve te papranueshme prane konteniereve (si pajisje elektroshtepiake, mobileri, inerte, krasitje kopshtesh etj)*
3. *koshat e vegjel ne shetitore perdoren nga banoret per mbetjet e tyre familjare, duke krijuar nje pamje shume te shemtuar.*
4. *Subjektet fizike, dhe juridike , dyqanet ambulante, hedhin mbeturinat dhe ambalazhet ne rruge pas orarit te pastrimit .*
5. *Qarkullimi i mjeteve te renda qe transportojne materiale inerte neper tmjet rrugeve kryesore te qytetit .*
6. *Parkimi i mjeteve ne te dy anet e rrugeve, duke u bere pengese per fshirjen e tyre.*
7. *Mungesa e xhepave me bazamente per kontenieret.*
8. *Mbledhesit e plastikës neper konteniere, pasi thyejne rrotat e konteniereve dh nxjerrin jashte tyre mbeturinat qe jane hedhur ne to.*
9. *Rritja e cilesise se sherbimit neper tmjet teknologjise bashkekohore*

OBJEKTIVAT:

1. Te vendosen koshat e vegjel ne cdo 250 ml .
2. Te hapen xhepa me bazament per konteniere.
3. Te arrihet qe ne cdo 100 banore te vendosen 1 kontanier per te evituar ndotjen e rrugeve. (shtimi i nr te konteniereve) .
4. Te realizohet ndertimi i i bazamenteve per pikat e grumbullimit per cdo pallat te ndertuar rishtas .
6. Gjate periudhes se veres te shtohet doza e dizifektimit me gelqere ne pikat e grumbullimit .
7. Gjate muajve te sezonit turistik te shtohet nr i pikave qe hiqen dy here ne dite mbetjet urbane .
8. gjate sezonit turistik per shkak te temperatura te larta rruget kryesore te qytetit te lagen gjate pikut te vapes per tu freskuar dhe ulur sasia e pluhurit.

C- SEKTORI I NDRIÇIMIT PUBLIK

Një sektor I rëndësishëm në Bashkinë Vlorë, është edhe Sektori I Ndriçimit Publik

Monitorimi

Funksionimi i sistemit të kontrollit të rrjetit të ndriçimit publik dhe evidentimi i defekteve bëhet nëpërmjet përgjegjësit , punonjësve të sektorit të ndriçimi publik, njësive administrative dhe komunitetit.

Ndjekja e procedurave për lidhjen e kontratave të reja nga specialisti përkatës.

Shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit administrohet nga Drejtoria e Investimeve Publike, Strehimit dhe Transportit. Sektori i mirëmbajtjes së shërbimit të ndriçimit të qytetit përbëhet nga:

Përgjegjës sektori, 7 elektriciste, 2 shoferë manovrator vinçi me kosh, 1 puntor ndricimi.

Mirëmbajtja realizohet me të ardhurat e Bashkisë, që mbulojnë: shpenzimet për blerje materiale të ndryshme për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik të cilat planifikohen çdo vit në bazë të preventivave dhe miratohen në buxhetin e Bashkisë. Këto materiale magazinohen dhe tërhiqen nga punonjësit e shërbimit të ndriçimit sipas nevojave gjatë gjithë vitit.

Ndriçimi public në Qytet, përfshin rrjetin e ndriçimit të shpërndarë si më poshtë:

- ndriçimi I rrugëve kryesore dhe dytësore
- ndriçimi I shesheve
- ndriçimi I parqeve dhe lulishteve

Asetet në dispozicion të shërbimit të ndriçimit public për qytetin janë:

- Numri I pikave të furnizimit të energjisë (kabinaveelektrike) që kanë kontratë 209 copë aktive, 25 copë të ngrira
- Numri I ndriçuesve të instaluar 7182 copë

Në territorin urban të qytetit ka 3 lloje shtyllash:

- dekorative: të cilat gjenden në zonat pedonale dhe disa nga parqet e qytetit;
 - çeliku:pothuajse të gjitha të zinkuara,përbëjnë pjesën dominuese të shtyllave që shërbejnë përndriçimin e qytetit;
- betoni: shtyllat i përkasin OSHEE, por ndriçuesit janë të Bashkisë.

Duke vlerësuar drejt situatën e Ndricimit Publik si dhe rëndësinë tepër të madheqë ka përsigurin e qytetarëve dhe në fushën e turizmit, gjatë tetë mujorit janë bërë këto punë:

BASHKIA VLORE

Riparimii 150 ndriçuesave 250W nërrugën “Demokracia”, ”, “Hasan Kushta”, “Dervish Hekali”, “4 Heronjtë”

Riparimi I difekteve elektrike në Institucione të qytetit.

Çmontimi dhe magazinimi I dekorit ekzistues të festive të fundvitit.
Riparimi I ndriçimit në rrugën“Unaza”, “PelivanLeskaj” dhe “ZenelMurra”.
Riparimi I ndriçimit në rrugën“Damian Humariti”
Riparimi I ndriçimit në rrugën“Demokracia” Vendorsjalinjëelektrike .
Riparimi I ndriçimit në rrugën“Niko Hoxha” dhe“ ThemisokliMone”.
Riparimi I difekteve elektrike, zëvendësimi I linjave elektrike të amortizuara.
Riparimi I ndriçimit në rrugën“Mustafa Bello” dhe “SulejmanDelvina”, “Dhimitër Konomi”.
Riparimi I ndriçimit pranë rrugës “DhimitërKonomi” nëparkiminpublik.
Riparimi I ndriçimit në rrugën “HysenBregasi”.
Riparimi I ndriçimit në rrugën pranë shkollës së Marinës dhe në rrugën “Laze Melo”
Riparimi I ndriçimit midis rrugës “Reshat Osmani dhe Shaban Demiraj”
Riparimi I ndriçimit në rrugën PelivanLeskaj, Reshat Osmani, ZenelMurra, David Selenicasi.

Zëvendësimi I ndriçuesave 100W dhe 50 W nërrugën Shaban Demiraj.
Riparimi I ndriçimit në rrugën“Gjergj Arjaniti”

NJËSITË ADMINISTRATIVE

NJ.A. QENDËR

Riparimi i 50ndriçuesave 250W nëNartë

NJ.A.SHUSHICË

Riparimi I ndriçuesave 250W dhe mirmbajtja e ndriçimit.

NJ.A.NOVOSELË

Vendosja e linjëelektrikepërndriçiminnëNJ.A.Novoselë, konkretisht në fshatin Poro dhe Skrofotinë.

Montimi i 10 shtyllave të ndriçimit nëNovoselë.

Zëvendësimi I kabllit të dëmtuar dhe riparimi I difekteve në panelat elektrikë.

Zëvendësimi I 20 ndriçuesave 100W Novoselë

NJ.A.ORIKUM

Riparimi i 70 ndriçuesave 250W.

Montimi i 20 shtyllave

Zëvendësimi i 25 ndriçuesave 100W të dëmtuar në Novoselë.

Riparimi I ndriçuesave 150W E40 dhe E27

Në qytet dhe në Njësitë e tjera administrative situata e ndriçimit është si më poshtë:

- Nj.A.Orikum: Në Orikum dhe në fshatrat ka 357 ndriçues
- Nj.A.Qendër: Në Kaninë ka 75 ndriçues. Në Nartë ka 40 ndriçues. Në Babicë të Madhe ka 145 ndriçues
- Nj.A.Novoselë: Në Novoselë dhe në Fshatrat ka 630 ndriçues
- Nj.A.Shushicë ka në total 180 ndriçues.

OBJEKTIVA:

1. Me materialet përmirëmbajtjen e ndriçimit të riparohen të gjitha rrugët ku ka ndriçues të dëmtuar, të fillohet me rrugën që të çonte spitali rajonal rruga “Ali Demi”, rruga “4 heronjtë” si dhe me njësitë administrative atyku ka problematika apo riparime.
2. Të riparohen prozhektorët 1000W në lungomare.
3. Të zëvendësohet kabli I vjedhur te lulishtja në lungomare dhe të ndizentë gjithë ndriçuesit.
4. Të bëhen riparime te rruga e spitalit me ndriçues 250W dhe 150W.
5. Të furnizohet me ndriçim shtylla që ndodhet te lulishtja pranë rrugës “PelivanLeskaj”.

Të zëvendësohet kabli në rrugën “Niko Hoxha”400ml.

Të zëvendësohet kabli në rrugën “Demokracia” 400ml.

D-SEKTORI I TRANSPORTIT

Sektori i transportit zbaton me përpikmeri të gjitha dispozitat për nxjerrjen e licencave dhe certifikatave për transport rrethqytetes , qytetes ,taksi,agjensi transporti dhe licencë tregtim karburanti.

Licensimi i subjekteve behet ne baze te Ligjit 8308 date 18.08.1998 ”Per transportet rrugore” , i ndryshuar, VKM dhe udhezimeve te MIE.

Gjate 8 mujorit të vitit 2023 është bërë licensimi i të gjithë atyre subjekteve të cilët kanë paraqitur kërkesat për licensim.

1-Taksi 4+1 janë licensuar 18 mjete .Ne bashki janë të licensuara rreth 120 mjete taksi 4+1 me afat 5 vjeçar.

2-Taksi 8+1, janë licensuar 16 mjete, me afat 5 vjeçar.

2-Certifikata për transport mallrash për llogari të vet janë 72 cope, për transport mallrash për të treta janë 24 cope, licence transporti mallrash për të treta 1 cope me afat 5-vjeçar.

3-Certifikata mjetesh rrethqytetase 43 cope.

4- Autorizime për shërbime taksi 8+1 brenda qarkut ,1 cope.

5-Agjensi transporti ndërkombëtar 2 cope.

6- Drejtoriajone pajis me licencetregtimkarburantisubjektetecilatregtojnëkarburant. Subjekteaktive në territorin e bashkisë janë 43 cope.

Nga këto 32 subjekte janë pajisur me licence 5 vjeçare dhe 11 subjektet nuk janë pajisur me licence dhe nuk kanë paguar taksat.

Në subjektet që nuk janë pajisur me licence janë bërë njoftime dhe verifikime në subjekte , duke lënë aktkonstatime dhe detyrë për pajisjen me licence. Kjo me një bashkëpunim shumë të mirë të DIIP , Policisë Bashkiake dhe Drejtorisë së taksave dhe Tarifave. Kjo punë do të vazhdojë në të ardhmen.

7-Sherbimi i transportit urban në qytet kryhet nga subjekti “Urban Trans Vlora”. Në këtë shërbim është kushtuar vëmendje e veçantë për të siguruar cilësinë e transportit urban duke u shërbyer sa më mirë komunitetit.

8-Taksa e parkimit është vjelë nga të gjithë subjektet në momentin që subjektet pajisur me lic+certif, dhe vlefte e taksës parkimit bëhet në bazetë VKB .

Të gjithë subjektet e cilat kërkojnë parkim për subjektet e tyre paguan taksën e parkimit me pagesë, në bazetë në kontratë të lidhur me Bashkinë e Vlorës me një afat një vjeçar dhe pagesa sipas VKB.

9- Sinjalistika rrugore horizontale dhe vertikale është bërë nga Ndermarrja e Shërbimeve Publike, duke bërë vije të mëdha dhe të vendpërkimeve të mjeteve taksi, transport rrethqytet, interurban.

-Në sinjalistikën vertikale për të bërë rregullimin e drejtimit të lëvizjes së automjeteve në disa pika problematike, ku fluksi i automjeteve është më i madh nga kapaciteti i rrugës janë vendosur tabela sinjalizuese dhe orientuese.

Problem i madh ne sinjalistiken vertikale mbetet mungesa e semaforeve ne pikat me problematike ne qytet.

Per te bere te mundur rritjen e te ardhurave nga transporti , Drejtoria e Infrastrukture dhe Investimeve Publike ka bashkepunuar me Drejtorine Tatim Taksave, dhe Policine Bashkiake, po megjithate ketu ka vend per permiresime qe keto kontrole te jene me te shpeshta.

Spektori i trasportit ka nje koospondence te mire me institucionet perkatesese si me DRSHTRR Vlore , MTT dhe institucione te tjera.

Puna ne lidhje me qytetaret pathuajse ka qene e mire, eshte gjetur nje bashkepunim i mire me ta duke mos patur probleme ne kete drejtim dhe duke bere te mundur zgjidhjen e problemeve te tyre.

- **Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe turizmit**

Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe turizmit përbëhet nga tre sektore kryesor:

- Sektori i Zhvillimit Ekonomik
- Sektori i Zhvillimit të Tregjeve
- Sektori i Turizmit

Normalisht funksionon vetëm sektori i turizmit në këtë drejtori dhe si sektor turizmi përgatit analizën 8 mujore mbi realizimin e detyrave që ajo ka zhvilluar.

PËRMBAJTJA:

1. Nje draft – plan mbi Prioritetet e turizmit në Vlorë

2. Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme

3. Statistika të Perpunuara nga zyra:

3.1 Investimet e reja në fushën e turizmit

3.2 Shpenzimet ditore dhe netëqëndrimet

3.3 Turistet e huaj që kanë vizituar vendin tonë

3.4 Subjektet Turistike Të Certifikuara Dhe Licensuara per Bashkinë Vlorë

3.5 Statistika

3.5.1 Të dhënat me tabele të numrit të vizitorëve sipas muajve(Vetëm per Bashkinë

Vlorë), krahasuar me vitet e kaluar 2021/2022/ 2023.

3.5.2 Të dhënat me tabele të numrit të vizitorëve sipas muajve per objekte të rëndesisë së vecantë (2022/ 2023)

3.5.3 Numri i Vizitoreve sipas Turizmi natyror, Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara, Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun, Kategoria V. Peizazh i mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) (2022/ 2023)

1. Nje draft – plan mbi Prioritetet e turizmit në Vlorë:

-Promovimi i qytetit si një qytet turistik dhe me potencial. Promovimi i qytetit jo vetëm si qytet bregdetar, por që ofron dhe turizmin malor, kulturor, kulinëtar etj, pra gjithëpërfshirës.

- Ofrimi i një mjedisi të pastër, si dhe mbrojtja dhe përmirësimi i tij. Përmirësimi i shërbimit në shtetore të ndryshme të turizmit.

- Mbështetja e zhvillimit të ekonomisë së qëndrueshme dhe në rritje.

- Tërheqja e një numri sa më të madh të vizitorëve dhe të turistëve në qytet dhe në rrethinat e saj. Plani i veprimit për turizmin synon të kontribuojë në rritjen e zhvillimit ekonomik të Vlores, synon në promovimin e zones si dhe në eksperiencat cilësore e të qëndrueshme të vizitorit nëpërmjet:

- Marketingu konsumator presupozon maksimizimin e përfitimeve ekonomike të turizmit nga qyteti dhe rrethinat e tij me anë të ndarjes së sezonit turistik sipas perjudhave kohore të ndryshme, pra shtrirjes së sezonit të vizitorëve dhe sidomos inkurajimit për të qëndruar më shumë nëpërmjet një marketingu efektiv dhe të targetuar.

1- Kërkimi marketing është një mjet shumë i nevojshëm për tu informuar mbi tendencat e tregut dhe performancën e tij

2- Brandimi është një tjetër aspekt i cili realizohet duke punuar për krijimin e një brandi të fortë, të identifikueshëm dhe qartësisht të dallueshëm për turizmin

3- Publikimet

4- Marketingu i qëndrimit të vizitorëve.

5- Shërbimet e Zyrave të Informacionit Turistik (Info Point) .

- Zhvillimi i destinacionit

1-Promovimi për turizëm jo vetem detar por edhe ai malor duke e kthyer Vlorën në një qytet turistik gjithë vitin.

Përmirësimi i faqes së web-it dedikuar turizmit, duke ofruar aty informacion turistik të gjithanshëm dhe të përditësuar.

2- Promovimi i dallueshmërisë lokale dhe zhvillimi i projekteve lokale.

2. Pjesemarrja ne aktivite te ndryshme:

- 1- Trajnimin për Bashkinë Vlorë datë 31.01.2023 ora 11.00-12.45 online
Datat 16 – 31 Janar 2023. Inputet tuaja do të pasurojnë kurrikulën ne trainimit të ASPA-s dhe Projektit “Bashkitë për në Evropë”,sa i përket fushës së integrimit evropian.
 - 2- 27.04.2023 Seminar në lidhje me projektin Resilienza Marginale. L’approccio leader – CLLD ed I GAL (Gruppi di azione Locale).- Pallati I Kultures Laberia – Salla Kati 2 ora 09.00 – 13.00
 - 3- 28.04.2023 Forumi I biznesit Shqiperi – Gjermani. Tema: Njohja më nga afër me potencialin dhe mundësitë konkrete që ka Shqipëria për investime. Njohjen me projektet që mbështet Qeveria Shqiptare dhe në fusha të reja për investime. Maritim Hotel Plaza Tirana, salla Mbretëresha Geraldine ora 09.00 nga Agjensia shqipëtare e zhvillimit të investimeve AIDA
 - 4- Në kuadër të task-forcës së menaxhimit të sezonit turistik 2023, ne datë 04.05.2023, ora 11:00 në ambientet e hotel belvedere, uji i ftohtë vlorë, mbledhja e task-forces per sezonin turistik 2023, për QarkunVlorë, nën drejtimin e ministres së turizmit dhe mjedisit znj. Mirela Kumbaro dhe Prefektit të Qarkut Vlore z. Flamur Mamaj
 - 5- Mbi realizimin e një fushate në sektorin e turizmit/Vlore ne daten 16 Qershor Organizatoret AIDA. Në kuader të vizitave qëAIDA kishte planifikuar në Vlorë nëbashkëpunim me Bashkinë Vlorë,
Bizneset e identifikuarat paraprakisht me të cilat u zhvilluan takimet janë:
 - * Chic Boutique Hotel & Spa
 - * Marina Premium
 - * Hotel IMPERIAL
 - * Yacht Hotel
 - * Maritim Marina Bay Resort
- Perfaqësuar nga Sara Zotaj, Head of Sector of Investment and Aftercar, Investment Directory
- 6- 16.6.2023 Tema:Mbështetje për integrimin ekonomik rajonal – pyetsori mbi barrierat tregtare në CEFTA. – Organizatoret AIDA Takimi ne Tirane prane hotel Rogneri. Ora 10.00 – 14.00

- 7- Tranimet nga ASPA- per konfirmim statusi Nenpunesi civil. Maj - Qershor 2023
- 8- 20 Qershor 2023 Takim në zyrë me përfaqesues të LIDL SHQIPERIA Znj Blerta Imeri-Dula për të folur për projektin e tyre për mbi zhvillimin e aktivitetit bazuar në statistikat e Turizmit në Vlorë.
- 9- Takimi për projektin Resilienza Marginale: Il modello della circular economy per la valorizzazione delle vocazioni territoriali.
- Te mërkuren dt 6 shtator 2023 ora 19.00 pm :
 - Te enjten dt 7 shtator 2023 ora 8.30 am – 14.00

3. Statistika te Perpunuara nga zyra:

3.1 Investimet e reja në fushën e turizmit

Në vitet e fundit vihet re një bum rritje e investimeve në fushën e turizmit. Gjatë këtij viti rritja nuk mund të shprehet më në %, por disa herë më e madhe se viti paraardhës. Interesimi i qeverisë shqiptare, i biznesit në këtë fushë duket si nga numri dhe sipërfaqja e ndërtimit, por dhe nga vlera e investuar.

Investime reale në fushën e turizmit që i kanë dhënë një hov qytetit dhe një fuqizim ekonomik të vazhdueshëm.

- Lungomare 1 dhe vazhdimi Lungomare 2
- Sheshi i Flamurit
- Zona historike – Muradie
- Investime në lagje të qytetit
- Bypassi i Vlores nje investim gjigand.
- Sheshi përpara Muzeut Pavaresi
- Aeroporti i Vlorës. etj

3.2 Shpenzimet ditore dhe netëqëndrimet

Një faktor i rëndësishëm në llogaritjen e të ardhurave që sjell turizmi është dhe llogaritja e netëqëndrimeve për vizitorët e huaj, që shpenzojnë 1 natë e më shumë në Shqipëri, si dhe shpenzimet mesatare ditore që të huajtë (jo rezidentë) shpenzojnë në Shqipëri.

Përsa i përket shpenzimeve mesatare ditore për 6 mujorin e parë të 2023 për shtetasit e huaj jorezidentë që vizitojnë Shqipërinë për qëllime biznesi, mesatarja ditore është 150 Euro, që llogaritet 25.5 euro më shumë krahasuar me të njëjtën kategori të një viti më parë. Ndërsa shtetasit e huaj që kanë qëndruar në Shqipëri për arsye personale kanë harxhuar një mesatare ditore prej 100 euro në ditë. Rritja është 30 Euro në ditë më shumë se mesatarja ditore e shpenzuar për arsye personale, në të njëjtën periudhë të vitit paraardhës. Përsa i përket kohëqëndrimit mesatar për jorezidentët, shifrat tregojnë se vizitorët e huaj që vijnë për qëllime personale gjatë periudhës gjashtëmujore të 2023 kanë një mesatare prej 5.5 netëqëndrimi. Ndërsa jorezidentët që kanë deklaruar si qëllim të vizitës së tyre në Shqipëri, arsye biznesi kanë pasur një mesatare prej 5 netë. Netëqëndrimet për arsye personale janë rriur me 1 nate krahasuar me vitin paraardhës po ashtu dhe netëqëndrimet për arsye biznesi janë rritur 1 natë më shumë me mesataren e netëqëndrimeve të të njëjtës periudhë të një viti më parë. Numri i netëqëndrimeve të jorezidentëve, për gjashtë mujorin e parë të 2023 kemi rritje të ndjeshme të netëqëndrimeve, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022.

Gjatë muajit Korrik 2023, numri i netë qëndrimeve gjithsej është rritur me 14,9 %, në krahasim me muajin Korrik 2022. Numri i netë qëndrimeve të vizitorëve rezident të cilët janë akomoduar ka shënuar rritjen më të lartë me 41,2 %.

Në muajin Korrik 2023, numri më i lartë i netë qëndrimeve është realizuar:

- sipas rajoneve në “Rajonin e Jugut“ (34,4 %);
- sipas zonave të afërsisë me bregdetin në “Zonat Bregdetare” (84,1 %);
- sipas llojit të strukturave akomoduese në “Hotele dhe akomodime të ngjashme” (91,8 %);

3.3 Turistet e huaj qe kane vizituar vendin tone

Sipas ministrisë Turizmit, përveç turistëve nga Kosova, të cilët mbajnë sërish vendin e parë për nga numri, gjatë 7 muajve të parë të këtij viti, turistë të shumtë kanë ardhur nga Spanja. Për periudhën janar-korrik 2023 kanë vizituar Shqipërinë dy herë më shumë spanjollë, se sa në janar-korrik 2022.

Krahasuar me vitin që shkoi, vizitorët nga Turqia kanë pasur rritje prej 142 përqind, ata nga Mali i Zi 62 përqind, nga Franca 58 përqind më shumë e kështu me radhe. Turistët nga Azia kanë pësuar një shtim të ndjeshëm, ku spikasin vizitorët nga Kina me 152 përqind më shumë se periudha janar-korrik 2022.

Këto shifra dëshmojnë për një sezon shumë të suksesshëm të turizmit veror 2023 në Shqipëri, i cili mund të shtrijë ndikimin pozitiv edhe tek turizmi kulturor dhe historik, që zakonisht zhvillohet në vjeshtë dhe në pranverë.

Rezident, Kosovë; Poloni ; Itali ; Gjermani; Maqedonia e Veriut, Bota të pa specifikuar

Sipas INSTAT gjatë muajit Qershor 2023, në Shqipëri kanë hyrë 1,007,033 vizitorë të huaj, vlerë kjo 66,6% më shumë se viti 2021 dhe 15% më shumë se muaji Qershor i 2022. Gjatë gjashtëmuajit të parë kanë hyrë në vendin tonë 3,396,932 vizitorë të huaj. Rritja krahasuar me vitin 2021, është në vlerën 101,2% më shumë ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022 rritja është 33% më shumë.

3.3 Subjektet Turistike Të Certifikuara Dhe Licensuara për Bashkinë Vlorë

-për arsye volumi të materialit tabelat respektive me të dhëna të detajuara, janë të depozituara në zyrë.

Operatorë turistik të licencuar për Bashkinë Vlorë janë gjithësej 29 biznese

Specialitet i veçantë - Hiking, Trekking, Climbing, Biking 1 biznes Person fizik

Agjenci udhëtimitë licencuar për Bashkinë Vlorë janë gjithësej 37 biznese

Mjetet lundruetë licencuar për Bashkinë Vlorë janë gjithësej 30 biznese

Struktura akomoduese (holeri, turizem, bujtina dhoma plazhi, motele, etje) 149 biznese

3.5 Statistika

3.5.1 Të dhënat me tabelle të numrit të vizitorëve sipas muajve (Vetëm për Bashkinë Vlorë), krahasuar me vitet e kaluar

(nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura) të përpunuara për Bashkinë Vlorë

Të dhënat nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, tregojnë se gjatë muajit Janar 2023 janë 93,975 vizitorë shqipëtar dhe të huaj që kanë vizituar zonat tona të mbrojtura. Rezulton se kemi një ulje të numrit të vizitorëve gjatë këtij muaji të parë të vitit në vlerën 41%.

Më poshtë po japim të dhënat me tabelle të numrit të vizitorëve sipas muajve (Vetëm për Bashkinë Vlorë), krahasuar me vitet e kaluar për të njëjtën periudhë:

Janar 2021	Janar 2022	Janar 2023	Ndryshimi në%
10,118	10,803	8,130	-25%
Shkurt 2021	Shkurt 2022	Shkurt 2023	
9,596	6,644	9,722	2%
Mars 2021	Mars 2022		
10,928	8,250	11367	38%
Prill 2021	Prill 2022		
14,189	14,097	20257	24
Maj 2021	Maj 2022		
22,755	24,811	45770	84
Qershor 2021	Qershor 2022		
43,955	43,957	61854	41

3.5.2 Të dhënat me tabelle të numrit të vizitorëve sipas muajve per objekte të rëndesisë së vecantë

EMËTIMI I INSTITUCIONIT	janar	2022	2023	%
MUZEU I PAVARSISË VLOREË		17	122	61.8
KALAJA PORTOPALERMOS		8	14	75
PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA 1		1	4	300
PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM		4	35	775
KALAJA E KANINËS		10	0	-100
	shkurt			
MUZEU I PAVARSISË VLOREË		97	163	68
KALAJA PORTOPALERMOS		20	24	200
PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA 1		5	0	-100
PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM		10	34	240
KALAJA E KANINËS		7	33	371

	mars			
MUZEU I PAVARSISË VLOREË		49	115	135
KALAJA PORTOPALERMOS		60	100	67
PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA 1		0	52	0
PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM		24	86	258
KALAJA E KANINËS		15	30	100
	prill			
MUZEU I PAVARSISË VLOREË		114	177	55
KALAJA PORTOPALERMOS		212	360	70
PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA 1		33	77	133
PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM		50	92	84
KALAJA E KANINËS		50	265	430
	maj			
MUZEU I PAVARSISË VLOREË		264	435	100
KALAJA PORTOPALERMOS		720	970	35
PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA 1		230	115	-50
PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM		382	347	-9
KALAJA E KANINËS		160	395	147
	qershor			
MUZEU I PAVARSISË VLOREË		161	240	49
KALAJA PORTOPALERMOS		1650	2200	33
PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA 1		50	118	136
PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM		127	183	44
KALAJA E KANINËS		120	350	192

Tabelë Pëmbledhese e numrit të vizitorëve

Perjudhe Janar - Qershor

	2022	2023	Ndryshimi ne %
MUZEU I PAVARSISË VLOREË	702	1252	178
KALAJA PORTOPALERMOS	2670	3668	137
PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA 1	319	366	115
PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM	597	777	130
KALAJA E KANINËS	362	1073	296

3.5.3 Numri i Vizitoreve sipas Turizmi natyror, Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara,Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun, Kategoria V. Peizazh i mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë)

Janar – Qershor për vitet 2022 / 2023

<p>Janar 2022</p> <p>Turizmi natyror- Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj 10,803 (765 vendas ,68 te huaj)</p> <p>Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 9.300(8.976 vendas,324 te huaj)</p> <p>Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 833 (765 vendas. 68 te huaj)</p> <p>Kategoria V. Peizazh i mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) 285 (256 vendas. 29 te huaj)</p>	<p>Janar 2023 Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj eshte 8.130 Turizmi natyror Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 9.300(8.976 vendas,324 te huaj)</p> <p>Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 25% e 20.750 vendas dhe te huaj.</p> <p>Kategoria V. Peizazh I Mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë)13% e18.982 vendas dhe te huaj.</p>
<p>Shkurt 2022</p> <p>Turizmi natyror - Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj 6.664</p> <p>Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 7 perqind e 38,301.</p> <p>Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 447(415 vendas. 32 te huaj)</p> <p>Kategoria V. Peizazh i mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) 519 (463 vendas. 56 te huaj)</p>	<p>Shkurt 2023</p> <p>Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj eshte 25,697</p> <p>Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 11% e42.100 vendas dhe te huaj)</p> <p>Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 25% e20.750 vendas dhe te huaj.</p> <p>Kategoria V. Peizazh I Mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) 13% e18.982 vendas dhe te huaj.</p>
<p>Mars 2022</p> <p>Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj 141.436</p> <p>Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 6.560(643 vndas,129 te huaj)</p> <p>Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 447 (415 vendas. 32te huaj)</p> <p>Kategoria V. Peizazh i mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) 519 (463 vendas. 56 te huaj) .</p>	<p>Mars 2023</p> <p>Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj eshte11,367</p> <p>Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 19% e 77.944 vndas dhe te huaj)</p> <p>Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 46% e 41.905 vendas. dhe te huaj)</p> <p>KATEGORIA V. PEIZAZH I MBROJTUR Nartë - Pishë Poro (Nartë) 9% e18.300 vendas. dhe te huaj) .</p>
<p>Prill2022</p> <p>Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj 14.097.</p> <p>Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 8.362(7895 vendas,467 te huaj)</p> <p>Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 564 (506 vendas. 58te huaj)</p> <p>Kategoria V. Peizazh i mbrojtur Nartë - Pishë</p>	<p>Prill2023</p> <p>Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj eshte 20,257</p> <p>KATEGORIA III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 7% e 6.458 vendas dhe te huaj.</p> <p>Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 3% e 36.163 vendas. dhe te huaj)</p>

<p>Poro (Nartë) 1.46 (.235 vendas. 234 te huaj) .</p>	<p>Kategoria V. Peizazh I Mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) 6000 tutiste vendas dhe te huaj.</p>
<p>Maj 2022 Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj 14.197. Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 8.362(7895 vendas,567 te huaj) Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 564 (506 vendas. 58te huaj) Kategoria V. Peizazh i mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) 1.46 (.235 vendas. 234 te huaj) .</p>	<p>Maj 2023 Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj eshte 45.770 Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 36% e 44.840 vendas dhe te huaj. Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 20% e 45.375 vendas. dhe te huaj) Kategoria V. Peizazh I Mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) 20% e 44.682 tutiste vendas dhe te huaj</p>
<p>Qershor 2022 Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj 43,957. Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 1 5.916 (13.562 vendas ,2.354 te huaj) Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 3.325 (2.270 vendas. 1.055 te huaj) Kategoria V. Peizazh i mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) 6,914 (.5.476 vendas. 1.438 te huaj)</p>	<p>Qershor 2023 Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj 45. 770 Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 9% e116.886 vendas dhe te huaj Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 9% e 45.375 vendas. dhe te huaj. Kategoria V. Peizazh I Mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) 12% e 44.682 turiste vendas dhe te huaj) .</p>
<p>Korrik 2022 Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj 106.027 Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 22.995 Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 6.443 vendas dhe te huaj Kategoria V. Peizazh i mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) 24.642 vendas dhe te huaj .</p>	<p>Do të plotesohen më vonë me daljen e të dhënave</p>
<p>Gusht 2022 Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te huaj 215.259 Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 27.788 vendas dhe te huaj. Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 13,243 vendas dhe te huaj) Kategoria V. Peizazh i mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) 100.000 vendas dhe te huaj) .</p>	<p>Do të plotesohen më vonë me daljen e të dhënave</p>
<p>Shtator 2022 Turizmi natyror Numri I vizitoreve vendas dhe te</p>	<p>Do të plotesohen më vonë me daljen e të dhënave</p>

huaj 116.364 Kategoria III-Monument Natyror Karaburun-Sazan 15.854 (10.875vendas. 4.979 te huaj) Kategoria III-Zonës së Mbrojtur :Llogara 27.788 vendas dhe te huaj. Kategoria IV- Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror:Karaburun 9.517(7.531 vendas dhe 1.986 te huaj) Kategoria V. Peizazh i mbrojtur Nartë - Pishë Poro (Nartë) 24.085 (20,435vendas dhe3.632 te huaj	
---	--

• Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social

DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL në Bashkinë Vlorë perfshin ne strukturen e saj 5 rajonet e bashkisë qytet si dhe kater NJA perkatesisht NJA Qender, Orikum,Novosele dhe Shushice.

Si një ndër Bashkitë kryesore që kanë hartuar dhe miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak një Plan të mirëfilltë Social 2018-2020, me objektiva të qarta, të matshëm dhe të realizueshëm si nje risi ne baze te implemetimit te projektit pilot per DI-in ne kuader te ngritjes së Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjet, konkretisht në muajin korrik 2021, ku shërbimeve sociale në bashkinë Vlorë i është tashme një hallkë e rëndësishme ndërveprimi e integruar në strukturën e shërbimeve Socialeve. Shërbimet e reja komunitare për fëmijën dhe familjen janë në fazën e transformimit nga IPSH në shërbime të reja komuntare emergjence dhe qëndër komunitare.

Aktualisht Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social është në momentin e përgatitjes së një plani të ri social me ekspetrë të kontraktuar nga Shërbimi Social për të nxjerrë prioritete të reja në bazë të nevojave komunitare.

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në bashkinë e Vlorës ka në fokus tek shërbimet e kujdesit shoqëror nevojat sociale në rritje të kategorisë së grupeve në vështirësi ekonomike për të gjithë komunitetin, të jenë të mbuluara me shërbime ekzistuese dhe shërbime të reja sociale, për të qënë sa më pranë qytetarëve sipas modeleve dhe praktikave më të mira bashkëkohore.

Shërbimet ofrohen në përputhje me standartet dhe kornizën ligjore të shërbimeve sociale duke u bazuar në qasjen me individin , si priotar në qëndër te cdo sherbimi, duke ngritur një sistem të balancuar shërbimesh sociale të cilat do të kenë në fokus target grupet në nevojë, duke synuar një mbulim më të mirë të nevojave të tyre, një mbulim më të plotë me shërbime të tjera të kujdesit shoqëror, nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve ekzistuese dhe ndërtimit të shërbimeve të reja.

- NDIHMA EKONOMIKE

Çdo muaj Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social paraqet Projekt-Vendimin e fondit të kushtëzuar 6% me fonde të deleguara nga buxheti i shtetit dhe Projekt-

Vendimin me të ardhurat e bashkisë ku trajtohen familje me probleme të thella sociale të cilat nuk janë përfituese të sistemit dixhital por në bazë të kriterëve specifike të miratuara në Këshillin e Bashkisë çdo fillim viti.

Numri i familjeve përfituesve në vështirësi ekonomike nga të ardhurat e bashkisë ka qenë afërsisht rreth 35 familje në muaj me një fond prej 1.068.500 Leke/ në 8 mujor.

Emërtimi	Përfitues të ndihmës ekonomike	
	Numër	Lekë
Bashkia	23	732.000
Njësia Shushicë	2	74.500
Njësia Qendër	2	111.000
Njesia Orikum	3	78.500
Njesia Novosele	1	72.500
TOTAL	31	1.068.500

Familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike ngafondi i kushtëzuar 6% për vitin 2023 janë trajtuar 14 familje me një fond 448.124 Leke, sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi	Përfitues të ndihmës ekonomike/8 mujor	
	Nr familje	Lekë
Bashkia	14	448.124
TOTAL	14	448.124

Në skemën e ndihmës ekonomike prioritet janë përfitueset kryefamiljare gra 187 persona, familje që janë të komunitetit rom 31, familje të cilat kanë në përbërje të tyre P.A.K 78, jetim deri në moshën 18 vjec - 21 persona, familje me trinjakë -2 familje ,viktima të dhunës 21 familje, fëmijë që janë me shërbim kujdestarie të gjyshërve ose të afermve të tyre – 4 dhe femije me aftësi të kuafizuar 2.

Numri i familjeve ne nevojë perfitues nga sistemi dixhital per 8-mujorin 2023 eshte si me poshte :

Emertimi	8-mujori 2023	
	Nr familje	Shuma 000/leke
Bashkia qender	437	20.260
Nj.ad.Orikum	23	1.415
Nj.ad.Qender	44	2.604
Nj.ad.Shushice	122	7.367
Nj.ad.Novosele	71	4.166

TOTALI	697	35.812
--------	-----	--------

Pagesat për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara kanë vazhduar pa ndërprerje për 8 muajt e vitit 2023 janë :

Emërtimi	P.A.K + kujdestarë		Tetraplegjik + kujdestarë		Verbëri kujdestari		Invalid		Total	
	Nr.	000/Le k	Nr.	000/Le k	Nr.	000/Le k	Nr.	000/Le k	Nr.	000/Le k
TOTAL	1964	171.116	566	97.757	651	79.931	2410	61.160	5591	409.964

- NJËSIA PËR ÇËSHTJET E DHUNËS NË FAMILJE

Nga Koordinatori Vendor i Dhunës në Familje për periudhën 8 muaj Janar-Shtator 2023 janë trajtuar gjithësej 43 raste dhune me vendime gjyqate lëshuar në formën e UMM dhe UM nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë të paraqitura pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social, bashki.

Këto raste dhune janë menaxhuar në bashkëpunim me Ekipin Teknik Ndërdisciplinar dhe në koordinim të përmiresuar mes aktoreve të këtij grupi, ku janë marrë edhe masat përkatëse për mbështetjen e plotë të viktimave.

Rastet e paraqitura si me vendim gjyqate ashtu edhe të vetëreferuara pranë Njesisë së Çështjeve Kundra Dhunës në Familje, janë menaxhuar në bashkëpunim me koordinatoren vendor dhe me antarët e Ekipit Teknik Ndërsektorial, duke u ofruar rasteve të dhunës, shërbime ligjore dhe psikologjike falas, shërbime këshillimi për burrat e dhunshëm, rastet e pajisura me UM janë trajtuar me Ndihmë ekonomike në masën 9900 lekë, duke kryer njëkohësisht monitorimet përkatëse në bashkëpunim me policinë vendore Vlorë, si dhe stafin e shërbimit Social, ndërmjetësim për punësim, informim dhe këshillim mbi të drejtat që ka një viktimë dhune në bazë të ligjit përkatës, ndërmjetësim për aplikim bonus qeraje si dhe ndërmjetësim për akomodim pranë strehëzave rezidenciale përkatëse.

Gjatë periudhës Janar-Shtator 2023 është ruajtur e njëjta mesatare mujore e rasteve të dhunës në familje ku secili rast është trajtuar me përparësi sipas nevojave të identifikuara me bashkëpunimin e ngushtë të të gjithë anëtarëve të MKR-së si dhe janë monitoruar rastet me Urdhër Mbrojtje duke vlerësuar dhe adresuar nevojat e rastit. Kryesisht në skemën e ndihmës ekonomike përfshihet edhe kategoria e viktimave të dhunës në familje të pajisura me UM duke përfituar kështu pagesën e ndihmës ekonomike në masën 9900 Lek.

Gjatë periudhës Janar-Shtator 2023 janë drejtuar në mënyrë të vazhdueshme UMM-të prej gjykatës, zyrës së Shërbimit Social. Çdo rast dhune i paraqitur pranë Drejtorisë së Ndhmës dhe Shërbimit Social ose çdo rast i referuar nga gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë është kontaktuar dhe është bërë vlerësimi i nevojave nëpërmjet një intervistimi mes koordinatorit të dhunes dhe viktimës. Pasi është vlerësuar nevoja e çdo rasti dhune koordinatori ka informuar viktimën dhe e ka referuar në institucionet përkatëse. Gjatë periudhës Janar-Shtator 2023 janë referuar 40 raste pranë klinikës ligjore “Vatra” dhe gjithashtu pranë specialistit keshillues për dhunuesit për mbështje psikosociale pranë Klinikës Ligjore “Vatra” ku viktimave të dhunës dhe personave ushtrues të dhunës, u është ofruar asistencë ligjore dhe psikologjike, zgjidhje martesore dhe kërkesepadi për UMM dhe UM si shërbime falas nga Klinika Ligjore e Qendrës Psiko-Sociale “Vatra”.

Duke bërë një analize të rasteve grupmosha më e prekur nga dhuna është fasha 26-35 vjec si dhe 36-45 vjec si raste dhune në familje. Grupmosha më pak e prekur nga ky fenomen është fasha 19-25 vjec. Femrat janë target grupi më i margjinalizuar nga fenomeni i dhunës. Statusi civil më i prekur nga fenomeni i dhunës në familje janë të martuar, më pas renditen kategoria e personave të divorcuar dhe më pak bashkëjetuesit. Niveli arsimor i ulet ka qenë më i prekur prej fenomenit të dhunës në familje dhe me pas niveli arsimor I mesëm kurse niveli arsimor i lartë ka qënë më pak i prekur prej dhunës për periudhën Janar-Shtator 2023.

- NJËSIA E MBROJTJES DHE TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Për periudhën Janar-Shtator 2023, ka menaxhuar në total 45 raste të mbartura dhe të reja të fëmijëve në nevojë për mbrojtje sipasproblematikave si vlerësime social-ekonomike të familjes për monitorim të rastit, për marrjen e përgjegjësisë prindërore nga prindi, rastet e fëmijëve të huaj të pashoqëruar dhe strehim pranë qendrave rezidenciale përkatëse.

Vizitat në familje kanë pasur karakter kryesisht vlerësues mbi situatën sociale-ekonomike të familjes dhe janë kryer në varësi të problematikave të cilat kanë patur rastet. Edhe për vitin 2023 me vendim keshilli bashkiak janë përfshirë në total 20 fëmijë për frekuentim kopshti dhe çerdhe nga të ardhurat e fondit të bashkisë. Këta fëmijë janë pjesë e familjeve me probleme specifikesocio-ekonomike, fëmijë të viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëtë viktimave të trafikimit. Një tjetër aktivitet në fushën e shërbimeve sociale, nga Njesia e Mbrojtjes së Fëmijëve në bashkëpunim me Shërbimin Mbështetës Për Fëmijët Dhe Familjet dhe animatorë u realizua Kampi Veror 2023, për një periudhë prej 15 ditësh në bashkëpunim me Fshatrat SOS.

Pjesëmarrja e anëtareve të GTN-se gjithashtu ka qënë e rregullt dhe të gjithë kanë marrë përsipër detyrimet ndaj rasteve dhe problematikave që ata paraqesin. Disa prej problematikave janë zgjidhur menjëherë kurse disa janë në proces për t'u zgjidhur duke kërkuar pak më shumë kohe. Gjithashtu janë marrë masa edhe për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge duke ngritur skuadra terreni në bashkëpunim me SHMFF dhe Qendrën Psiko-Sociale

“Vatra”përgjatë sezonit veror turistik. Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrotje dhe i rasteve të fëmijëve viktime të dhunës në familje është realizuar me staf të plotë dhe të mirëorganizuar.

- NËPUNËSI PËR ÇËSHTJET E BARAZISË GJINORE

Për periudhën Janar-Shtator 2023, nëpunësi I barazisë gjinore ka asistuar në mbështetje me shërbime sociale si ndërmjetësim për aplikimi dokumentacioni për bonus qeraje, asistim në vlerësimin e nevojave të rastit si dhe referim pranë institucioneve ofruese shërbimesh falas. Ka qenë pjesëmarrës në 5 mbledhjet e këshillit bashkiak.

Nëpunësi I barazisë Gjinore ka qënë pjesë aktive edhe në vlerësimet e problematikave sociale pranë rajoneve të bashkisë Vlorë, duke identifikuar dhe evidentuar familje me problem sociale të ndryshme për ti referuar më pas pranë Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Njesisë së Dhunës në Familje ashtu edhe pranë Shërbimit Mbështetës për Fëmijët dhe Familjet.

Nëpunësi gjinor ka qenë pjesëmarrës edhe në tryezat konsultative mbi çështjet e barazisë gjinore të realizuara nga institucioni I Komisionerit Antidiskriminim, si dhe pjesëmarrës në trajnime të ndryshme nga OJF-të me fokus barazinë dhe drejtësinë gjinore si dhe dhunën me bazë gjinore.

Ka asistuar në seanca gjyqësore në bashkëpunim me Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijëve, për çështjet e fëmijëve me problematika socio-ekonomike si dhe ka asistuar në vlerësimet e nevojave të rasteve të dhunës në familje dhe në monitorimet në bashkëpunim me Koordinatorin Vendore të Dhunës dhe ka qënë pjesëmarrës aktiv si në ETN-te ashtu edhe në GTN e realizuara mbi çështjet e ndryshme dhe problematikat sociale të paraqitura pranë DNSHS-së.

- SHËRBIMET MBËSHTETËSE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN

AKTIVITETET DHE SHËRBIMET E OFRUARA GJATË 8 MUJORIT TË 2023.

Shërbimet bazë	Shërbimet e detajuara
- Ngelen pajisjet e zyrës përfundimtare.

V.O 7 – Furnizimi dhe vendosja e koshave nën tokësore në zonën turistike të Vlorës nuk ka filluar pasi nuk është bërë e mundur furnizimi i koshave nga prodhuesi në Poloni si pasojë e bllokimit të llogarive bankare të kontraktorit.

V.O 8 – Rehabilitimi i bazamentit të koshave sipërfaqësore ku përfshihen punime civile dhe punime dherash është realizuar 15%.

4. Plani vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve (PVMIM)

MIM Vlorë ka marrë pjesë në diskutime dhe ka kontribuar në hartimin e dokumentit të PVMIM të Bashkisë Vlorë si pjesë e Grupit të Punës të ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. PVMIM të Bashkisë Vlorë ka përfunduar dhe është miratuar nga Këshilli Bashkiak Vendim Nr.26 Dt.31.03.2023.

Përfaqësues të MIM Vlorë, kanë marrë pjesë në takimin final të projektit "Monitorimi i planeve të qeverisjes vendore për zbatimin e masave horizontale mjedisore sipas detyrimeve të BE-së". Një prej pikave të diskutimit në takim ishte dhe rritja e bashkëpunimit me OSHC-të, të rinjtë aktivist dhe mediat për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e trajtimit të mbetjeve në mbrojtjen e mjedisit.

5. Projekti : Klubi Shumesportesh

Programi : K08140 - Klubi Shumesportesh

- **Klubi Shumesportesh Flamurtari**

Përgjatë 8 mujorit të vitit 2023 kanë vazhduar aktivitetet zyrtare në Pallatin e Sportit Flamurtari dhe puna për përfaqsimin sa më të denjë të Klubit dhe Bashkisë Vlorë. Ky 8mujor ishte një sukses i madh për ekipet e Flamurtarit pjesë e Klubit. Ekipi i femrave në basketboll të rritura u shpall kampion kombëtar për sezonin 2022 – 2023 pas zhvillimit të katër ndeshjeve finale me ekipin e Partizanit me rezultat final të ndeshjeve (3-1). Falë mbështetjes së Bashkisë Vlorë dhe të Klubit ekipi mbylli një sezon fantastik ku përveç titullit Kampion Kombëtar fitoi Kupën e Federatës, Superkupën dhe Kupën e Shqipërisë. Gjithashtu ishte dhe ekipi finalist i Ligës Unike 2022 – 2023. Një sukses të merituar ka arritur dhe ekipi i meshkujve të rritur në basketboll ku me shpalljen kampion në Kategorinë I për sezonin 2022 – 2023 pas shumë vitesh mungesë sezonin tjetër ekipi i Flamurtarit është pjesë e Superligës . Gjatë 8mujorit pati rritje në cilësinë sportive te ekipet e moshave në basketboll vajza dhe djem por për sezonin që po fillon do të përpiqemi që të paktën një nga ekipet e moshave të shpallet kampion në kampionatet respektive. Në disiplinën e volejbollit ekipi i të rriturave arriti të fitonte Kupën e Shqipërisë për Kategorinë I , ndërsa ekipi i volejbollit U20 vajza arriti në gjysëm finalet e Kampionatit Kombëtar U20 F, si dhe ishte ekip finalist i Kupes Rinia 2022 – 2023.

Një sezon mjaft i suksesshëm ishte dhe për ekipin e Futsal i cili pas një kampionati shumë të bukur arriti të ishte finalist me ekipin e Tiranës dhe u shpall nënkampion për sezonin 2022-2023.

Në disiplinën e Kickbox ekipi ka arritur të mbrojë titullin kampion bote. Në disiplinën e atletikës kemi kampion kombëtar në hedhje disku dhe 100 metërsh. Gjithashtu dhe në peshëngritje kemi kampion kombëtar për moshat u18. Ekipi i shahut , qitjes, taekwondo, karate kanë marrë pjesë në aktivitetet zyrtare gjatë këtij 8-mujori me rezultate të kënaqshme.

Ndër aktivitetet e tjera të organizuara nga Klubi në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë gjatë këtij 8 mujori vlen për tu përmendur Final Four i Ligës Unike në datat 14 -17 Mars 2023, 100 vjetori i

Klubit Flamurtari në datat 20 -25 Mars 2023, Maratona “Vlora vrapon 2023” në datën 7 maj 2023 si dhe Steka e Artë 2023 në datat 25 – 27 gusht 2023

Në 15 – 17 mars 2023 në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, Federatën Shqiptare të Basketbollit, Federatën e Basketbollit të Kosovës, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar organizuam aktivitetin mbarëkombëtar Final Four Liga Unike. Ishte një aktivitet i mirëorganizuar i cili morri vëmendje të madhe si nga tifozeria, media dhe mbështetësi kryesor Bashkia Vlorë, pasi përkoji dhe me vitin jubilar të krijimit të Klubit Flamurtari. Ekipi i Flamurtarit basketboll femra të rritura u shpall nënkampion i Ligës Unike për sezonin 2022 -2023.

Në datat 20 – 25 Mars u organizua java e aktiviteteve për 100 vjetorin e Klubit. Përgjatë kësaj jave u organizuan një sërë aktivitete në disiplinat basketboll, volejball, çiklizëm , shah , ping pong , atletikë etj duke përfshirë dhe sportistë veteranë në këtë 100 vjetor të shënuar të Klubit. Në mbyllje të aktivitetit u organizua një mbrëmje jubile me sportistë veteranë , të rinj dhe familjarë e tyre në teatrin Petro Marko. Në këtë mbrëmje na nderoi me pjesëmarrjen e tij dhe Kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama.

Në datën 7 maj 2023 u zhvillua për vitin e 3-të radhazi maratona Vlora Vrapon 2023 me pjesëmarrjen e rreth 500 sportistëve jo vetëm nga trevat shqiptare por dhe nga shtete të ndryshme europiane. Këtë vit u organizuan dy disiplinat ajo 5 km dhe 10 km. Për vitin që vin synojmë të organizojmë dhe itinerarin 21 km. Vlen për tu përmendur pjesëmarrja e kampiones tonë kombëtare Luiza Gega e cila ishte dhe fituese e vendit të parë për femrat për distancën 10 km. Për meshkujt në vend të parë u rendit atleti serb Elzan Bibic. Gjithashtu çmime u shpërndanë dhe për katëgorinë veteran femra dhe meshkuj. Dita e maratonës ishte një sukses i vërtetë dhe një sukses i vërtetë për qytetin e Vlorës.

Në datat 25 – 27 gusht 2023 u zhvillua kampionati “Steka e Artë 2023” nga Federata Shqiptare e Bilardos dhe Snookerit në bashkëpunim me Klubin dhe me mbështetjen e Bashkisë Vlorë. Garat u zhvilluan në mbrëmje dhe pati një numër të lartë sportdashësish që e ndoqën këtë kampionat. Pjesëmarrja në këtë aktivitet jo vetëm nga sportistë nga Shqipëria por dhe nga Zvicra dhe Kosova. Kampion u shpall Edmond Zaja, në vendin e dytë Labinot Markaj nga Kosova dhe në vendin e tretë Besmir Cufe i Flamurtarit.

Për tu përmendur përgjatë këtij 8-mujori është dhe vazhdimi i bashkëpunimit me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe mbylljen me sukses për këtë sezon të Projektit Ekipet Sportive 2022.

Treguesit financiarë për 8-mujorin janë si më poshtë :

	Projekti	PLAN VJETOR	FAKT 1 Janar- 31 gusht 2023
1	Basketboll Femra te rritura	8,300,000	6,515,465
2	Basketboll Meshkuj	6,445,000	4,804,900

3	Basketboll Meshkuj te rinj	300,000	243,585
4	Basketboll Femra te reja	75,000	75,000
5	Volejboll te rritura	1,900,000	951,475
6	Volejboll te reja	400,000	389,965
7	Boks	3,657,000	2,996,875
8	Ciklizem	600,000	369,375
9	Mundje	700,000	391,900
10	Futboll	300,000	171,250
11	Peshengritje	1,400,000	1,116,990
12	Karate	300,000	221,250
13	Minifutboll	1,000,000	990,250
14	Qitje	500,000	398,750
15	Taekwondo	300,000	175,000
16	Bilardo	700,000	451,250
17	Atletike	300,000	171,250
18	Shah	350,000	228,170
19	Kick BOX	1,800,000	1,034,500
20	PING Pong	300,000	215,750
21	Energji elektrike	400,000	242,748
22	Uje	100,000	56,820
23	Telefon	80,000	50,200
24	Publicitet Foto Banera	960,000	799,700
25	Shperblime ekipi	1,000,000	884,003
26	Grumbullim	1,100,000	1,081,766
27	dieta personel	280,000	214,560
28	Federime + Gjyqtari	2,100,000	2,081,750
29	MARATONA 2023	800,000	800,000
30	Blerje te vogla, shp te tjera	880,000	802,176
31	TOPA + UNIFORMA	640,000	237,600
32	Projekte shtese	3,306,530	3,306,530

6. Projekti : Qendra Kulturore dhe Teatri

Programi : K08250 - Qendra Kulturore

**Aktivitetet e realizuar në Muzeun Historik dhe Etnografik
Periudha (Janar – Gusht 2023)**

JANAR

1. **16 Janar** – aktivitetpërdatëlindjen e Ismail Qemalit me nxënësit e shkollës “Nr.1”, me temë: “Tënjohimfigurën e Ismail Qemalit. Roliitjnëshpalljen e Pavarësisë nëvecantidhenëpolitikëshqiptaretëfillimshek.XX, nëpërgjithësi

2. **20 Janar** - 1944 inagurohet Brigada V sulmuesenë Bramyshnje (Tërbac). Brigadëheroike e bijvetëdenjë të Vlorës. Aktivitet në Muzeun Historik – Arkeologjik me Shoqatën e Veteranëve.

3. **21 Janar** - Aktivitet në përshkollatë mesme, “Elite”, “Nr.1”, “Halim Xhelo”, “Ali Demi” me temë: “Delegatët e Vlorës në Kongresin e Lushnjës”

4. **22 Janar** – Aktivitet në përshkollatë mesme, “Halim Xhelo”, “Ali Demi” me temë: “Arsyet e dorëheqjes së qeverisës së Vlorës 1912 – 1914”.

5. **24 Janar** – Përkujtohet vdekja e Ismail Qemalit.

Aktivitet në Muzeun Historik – Arkeologjik me pikturadhe vizatimet e realizuar nga nxënësit e shkollave të qytetit. Sqarohet më gjithashtu që: Ashtu sikurse ka mbetur dilemë datëlindja e Ismail Qemalit (16 janar apo 24 janar 1844), po ashtu edhe data e vdekjes ende nuk është zgjidhur (24 janar apo 26 janar). Përtë mosfolur pastaj përshkak të vdekjes

(natyrale apo helmim). Ismail Qemali do të varroset më 12 shkurt 1919, në Kaninë, në varrezat e familjes së tij.

6. **27 Janar** – Përkujtohet “Dita e Kujtesës”, përtë mos harruar kurrë viktimat e shkakuar nga gjenocidi nazist dhe holokausti.

“Kujtojmë dhe respektojmë tërënë nga qyteti i Vlorës në kampet e përqëndrimeve naziste”. Midis viteve 1939 – 1944 janë burgosur dhe internuar nga qyteti i Vlorës rreth 1641 qytetarë dhe për fat të keq shumë e pak prej tyre i kanë mbijetuar kampeve të përqëndrimit dhe janë kthyer në atdhe.

SHKURT

7. **2 Shkurt** - Aktivitet në Muzeun Etnografik. Kujtojmë dhenderojmë në ditën e lindjes Marigo Posio (2 shkurt 1882). Aktivitet me temë “Marigo Posio – jo vetëm qëndistare e flamurit”. Ajo ishte një grup poliedrik dhe ndër të paktat femra intelektuale të qytetit të Vlorës.

8. **6 Shkurt** – Aktivitet në Muzeun Etnografik. Kujtojmë botimin në Vlorë nga Marigo Posio, të gazetës "Shpresa Kombëtare" me 6 shkurt 1921. Gazetë e përdyjavshme shoqërore e letrare, organ ishqerisësë grave "Shpresa Kombëtare". Numri i parë doli në 6.2.1921 dhe u botua ngjithësej 6 numra. Trajtohet problemi shoqëror që lidheshin me çlirimin e gruas, propagandë irrugëniluministepërrolin e arsimit dhe të edukatës për brezin e ridheve çanërishtë përshkollat e përbashkëta të djemve dhe vajzave.

9. **13 Shkurt** – Aktivitet në Muzeun Etnografik.

Kujtojmë Klubin Labëria.; Më 1909, një ndër veprimtaritë e klubit atdhetar Labëria ishte dhe krijimi i teatrit në Vlorë. Shfaqja e parë që organizoi teatri ishte drama “Vdekja e Pirros”, përgatitur nga Mihal Grameno.

MARS

10. **Mars** – Aktivitet në Muzeun Historik dhe Etnografik me nxënësit e shkollave të mesme dhe 9 – vjeçare, me temë: Roli i Marigo Posionë “Klubin Labëria” si grup, mësues, intelektual dhe gazetar.

11. **15 Mars** - Muzeu Historik - Arkeologjik, u vizitua ditën e sotme nga shkollat e mesme "Ali Asllani" e Kotës. Nxënësit u njohën me objektet arkeologjike që janë gjetur në Kotë dhe me rëndësinë e figurës së Ali Asllanit.

12. **24 Mars** – Aktivitet në Muzeun Etnografik me nxënësit e shkollës 9 vjeçare “Teli Ndini” me temë: “Kostumet e grupave të vëllezëtarëve, të realizuar nga piktorët në qytetin e Vlorës, Petrit Ceno”. Këto veshje janë përdorur në fund të shek. XIX - fillim të shek. XX, për rastet e festave, dasmash dhe ceremonish fetare.

PRILL

13. **18 Prill** – Ditë e kombëtare e monumenteve dhe e lokaliteteve. Aktivitet në Muzeun Historik dhe Etnografik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare.

14. **22 Prill** – Aktivitet në Muzeun Historik me nxënësit e shkollës “Elite” me temë: “Avni Rustemi – Jo vetëm atentatori i Esat Pashë Toptanit” Përkujtohet sot 99 vjetori i ndarjes nga jeta e Avni Rustemit.

Avni Rustemi vdiq pas një atentati që iu bë në Tiranë më 22 prill 1924. Vendlindja e tij ishte Libohova (22 shtator 1895) por varrimin e bënte në Vlorë më 29 prill 1924.

15. **25 Prill** - Aktivitet në Muzeun Historik me nxënësit e shkollës “Rilindja” Kongresi i mbajtur në Vlorë më 25 prill 1921, krijoi një shoqëri, që mori emrin Federata " Atdheu". Kryetar ndër i saj u zgjodh Avni Rustemi.

16. **29 Prill** - Në kuadër të nisjes së "Edukimit për meskulturën", nxënësit e shkollave "Idriz Rustemi" (Risili), "Faslli Danaj" (Llakatund) dhe "Halim Xhelu" (Vlorë), vizituan ambientet e Muzeumeve - Vlorë (Muzeu Historik dhe Etnografik).

Mesazhi që u përcollte nxënësit ishte: "Trashëgimia jonë kulturore është njëherit promovuar turizmin historik, arkeologjik dhe etnografik të zonës ku jetojmë".

MAJ

13. **5 Maj** – Dita e Dëshmorëve. Aktivitet në Muzeun Historik me temë: “Vloragjatë Luftës së Dytë Botërore. Dëshmorët dhe Heronjtë nga qyteti.”

14. **18 Maj** – Ditë e kombëtare e Muzeumeve. Vizitë e nxënësve të qytetit tek Muzeu Historik dhe Etnografik.

15. **29 Maj** – Aktivitet me nxënësit e shkollave të mesme me temë:

“Roli i Kuvendit të Bacallasënë Luftën e Vlorës”

QERSHOR

16. **5 Qershor** – Aktivitet në Muzeun Historik.

Tema: “Kujtojmë Luftën e Vlorës. Roli i cetaeve të vullnetarëve të Luftës e Vlorës”.

17. **27 Qershor** – Përkujtohet genocidi çam (1944 – 2022)

KORRIK

18. **1 Korrik** - Ekspozitë me temë: “Vloranësytë e Edward Lear”

19. **20 Korrik** – Dita e Veteranëve (1957 – 2022)

Nderim dhe respekt për të gjithë veteranët, dëshmorët dhe heronjtë, përbetejat e realizuar dhe gjakun e derdhur për çlirim e vendit.

GUSHT

20. **Gusht**- Ekspozitë me temë: “Përlindja e Shqipërisë - Gazeta e parë e shtetit të pavarur shqiptar”.

<p style="text-align: center;">Aktivitetet e realizuar në Pallatin e Kulturës dhe TEATRIN E KUKULLAVE Periudha (Janar – Gusht 2023)</p>

- Aktivitete periudha : Janar – Gusht 2023

Shfaqja KËSULËKUQJA :

1.11 - 12 Shkurt 2023

Fëmijët e qytetit

2.18 - 19 Shkurt 2023

Fëmijët e qytetit

3.23 - 24 Shkurt 2023

Shkolla "4 Heronjtë"

4.25 - 26 Shkurt 2023

Fëmijët e qytetit

5. 4 - 5 Mars 2023

Fëmijët e qytetit

Shfaqja 3 DERRKUCËT :

1.11 - 12 Mars 2023

Fëmijët e qytetit

2.18 - 19 Mars 2023

Fëmijët e qytetit

3.22 Mars 2023

Shkolla "Jani Minga "

4.23 Mars 2023

Shkolla " Internacional "

5.25 - 26 Mars 2023

Fëmijët e qytetit

PRILL 2023

6.Fillon puna përpremierën e re tëTeatrittëKukullaveVlorë,premiera me kukulla " PESHKU I ARTË "

MAJ - QERSHOR 2023

Shfaqja e premierës "Peshkuiartë"përpubliku.

Data 1 QershorShkolla "4 Heronjtë"Shkolla "MuçoDelo"Kopështi "Dream Island"

Data 2 QershorKopështi "Dashuria"Shkolla "Rilindja"Shkolla "MuçoDelo"ShkollaAvni Rustemi"

Data 3 QershorFëmijët e qytetit

Data 4 QershorFëmijët e qytetit

Data 5 QershorShkolla&Kopështi "Internacional"

Data 7 QershorShkolla "MarigoPosio"

Data 10 QershorFëmijët e qytetit

Data 11 QershorFëmijët e qytetit

Data 26 - 27 QershorVlorahistorike "Muradije"

Data 4 - 5 KorrikSheshi "3 Racat"

Data 6 - 7 KorrikKinemajaVerore "Lungomare"

Luaj & Sfid

Të rinjtë e katër gjimnazeve të qytetit u bënë bashk në aktivitetin argëtues : "Luaj dhe sfido", organizuar nga Qendra Kulturore e Bashkisë Vlorë dhe ZVA, Vlorë - Himarë.

Një mikse show, i konceptuar dhe realizuar plot shije e kulturë nga profesionistët e Qëndres Kulturore dhe i mbështetur nga nxënësit dhe mësuesit e shkollave "Ali Demi", "Halim Xhelo", "Jani Minga" dhe " Mustafa Qemal Ataturk".

Argëtim, Inteligjencë, shkathtësi dhe mbi të gjitha art, ishin elementë të performancës së të rinjve për të vazhduar më tej me të tjera aktivitete që Bashkia e Vlorës dhe Qendra Kulturore e saj kane përgatitur.

Akademi nderimi per Pavarsine e Kosoves.

Ceremoni Perkujtimore festive me rastin e 15 vjetorit te Pavarsise te Kosoves ne bashkepunim me Universitetin Ismail Qemali ,Shoqata Laberia , Drejtoria Arsimore.

Festivali Folklorik i Gjirokastrës .

Paraqitja dhe perzgjedhje me ndihmen e dy specialisteve Folklori e grupeve qe do paraqiten ne festivalin Folklorik te Gjirokastrës.

Mbremje Folku Koncert i Asamblit Amantia.

Me pjesmarrjen e grupit te valleve popullore. Grupi polifonik, kengetare Nazif Cela , Katina Beleri , Vendim Kapaj. Si dhe pjesmarrjen e te mirnjohurve Viktor Tahiraj dhe Ludmilla Baballeku. Ne sheshin prane Kinemase Verore ne Lungomare 23 Korrik 2023.

Aktivitetet e realizuar ne Biblioteken Publike “ Shevqet Musaraj” Periudha (Janar – Gusht 2023)

Ne zbatim te Programit te Aktiviteteve per vitin 2023, ne Biblioteken Publike “ Shevqet Musaraj”, gjate periudhes Janar – Gusht te ketij viti jane zhvilluar nje sere aktivitetesh si me poshte:

Muaji	Lexues	Libra
Janar	842	5102
Shkurt	1313	5339
Mars	1344	5356
Prill	204	5203
Maj	245	6365
Qershor	265	6540
Korrik	230	6930
Gusht	237	5100

Muaji Janar

1 promovim, 3 ekspozita
20 aktivite ne b/punim me Kendin Amerikan Vlora.

Muaji Shkurt

2 ekspozita,30 aktivitete, ne b/punim me Kendin Amerikan Vlora.

Muaji Mars

2 ekspozita,36 aktivitete, ne b/punim me Kendin Amerikan Vlora.

Muaji Prill

Gjate muajit prill ne biblioteke jane hapur disa ekspozita me libra te rinj(blerje nga fondet e Bashkise).Jane zhvilluar aktivitete me rastin e 22 prillit Dites se Tokes si dhe 23 prillit Dites Boterore te Librit,ne bashkepunim me shkollat e qytetit dhe Qendren Rinore Vlore.Ne dt 28 prill Biblioteka u vizitua nga perfaqesues te Ambasades Amerikane ne Tirane,te cilet dhuruan libra dhe pajisje elektronike.Ne Kendin American jane zhvilluar reth 40 aktivitete me tematika te ndyshme me nje numer pjesemarrësish rreth 950.Numri i lexuesve te rinj per kete muaj eshte 204 dhe jane qarkulluar 5203 libra.Gjate muajit ka pasur nje frekuentim prej rreth 2500 perdoruesish .

Muaji Maj

Ne muajin maj ne biblioteke jane celur 2 ekspozita tematike me rastin e 5 majit Dites se Deshmoreve dhe 9 majit Dites se Fitores mbi Fashizmin.U zhvilluan aktivitete me femije te kopshtit " Kridenel" (ne sektorin e femijeve) si dhe nxenes te shkolles "Jani Minga".Ne kendin amerikan u zhvilluan rreth 38 aktivitete te ndjekua nga 975 pjesemares.Numri i lexuesve te rinj per kete muaj eshte 245,jane qarkulluar reth 6365 libra.Numri i perdoruesve per kete muaj 2430.

Muaji Qershor

Me rastin e 1 Qershorit u zhvillua nje aktivitet me nxenes te shkolles "Selam Musai"Babice.Ne 3 qershor aktivitet me nxenes te shkolles jopublike "Fan Noli",te cilet pasuruan fondin e bibliotekes me libra te rinj.Ne daten 14 ne bashkepunim me Klubin e Shkrimtareve "Petro Marko"u zhvillua aktiviteti kushtuar krijimtarise letrare te prozatorit Kujtim Lapaj.Gjate muajit biblioteka u vizitua nga nxenes te shkollave "Fan Noli", "Internacional",Qendra" Laurel"etj.Ne kendi amerikan u zhvilluan 34 aktivitete te ndjekura nga 1040 pjesemarrës.Numri i lexuesve te rinj eshte 265,jane qarkulluar reth 6540 libra.Numri i perdoruesve gjithsej 2650.

Muaji Korrik

Ne 14 korrik u zhvillua aktiviteti Netet e Librit organizuar nga Ministria e Kultures,Qendra Kombetare e Librit dhe Bashkia Vlore.Ne daten 27 u zhvillua trajnimi me temen : "Te rinjte dhe korrupsioni" ne bashkepunim me Qendren Rinore Vlore.Gjate muajit jane zhvilluar ore te hapura leximi,vizatimi,filmi per te argetuar femijet ne ditet e pushimeve.Jane ekspozuar gazeta te vjetra pjese e fondit te vjeter te bibliotekes.Ne kendin amerikan jane zhvilluar 35 aktivitete te ndjekura nga 1300 pjesemarrës.Numri i lexuesve te rinj per kete muaj eshte 280,jane qarkulluar reth 6930 libra.Numri i perdoruesve gjithsej 4750.

Muaji Gusht

Gjate muajit Gusht u zhvillua aktiviteti me rastin e Dites Nderkombetare te Rinise ne bashkepunim me Qendren Rinore Vlore. Po keshtu jane zhvilluar aktivite te ndryshme argetuese per femijet ne ditet e pushimeve si ore lojrash, leximi, vizatimi e filmi me rreth 560 pjesemarres. Numri i lexuesve te rinj eshte 237 dhe qarkullimi i librit 6750. Numri i perdoruesve qe kane marre sherbim ne biblioteke gjithsej per kete muj eshte 5100.

Programi : K08280 - Teatri

• Teatri “Petro Marko”

Analiza e punës për Teatrin “Petro Marko” për periudhën 01.01.2023 – 31.08.2023

Duke u nisur nga qëllim kryesor i punës për Teatrin “Petro Marko”, pasurimin e jetës artistike e kulturore në qytetin e Vlorës, juparaqesim aktivitetin e këtij Institucioni për periudhën 01 Janar 2023- 31 Gusht 2023 si më poshtë:

1. Komedi e trishtënga Dusan Kovacevic “Profesionisti”, Regjite Leka Bungo, me lojën e artisteve të mëdhenj Viktor Zhusti, Astrit Hasanidhe pjesëmarrjen e aktoreve profesioniste të Teatrit “Petro Marko”, Artan Islamidhe Matilda Avduli, me mbështetjen e Bashkisë Vlore. Kjo komedi pati sukses dhe u duartrokit gjatë për 6 nete në Teatrin “Petro Marko”, nete të tërmbushura plot me spektatore., gjatë muajit Janar 2023.
2. Koncert “Ricchi e Poveri”, grupi i njohur Italian, me 31 Janar 2023, Koncerti qe tërmbushisallen e teatrit “Petro Marko”.
3. Drama “Gjakui Martireve të Kombit”, dramesipas romanit me tenjëjtintitullteshkrimtares Zana Tako, regjia Bajram Torba, me lojën fantastike BUJAR ASQERIU dhe trupës së aktoreve të mëkullueshem GËZIM RUDI, MARGENT ÇAUSHAJ, ERJON HINAJ, LINDAR KAJA, ALBA SHTËMBARI, DELVIS BEJLERI, ALBAN MUSAKU, LEDION GJEÇI.
Drama u shfaq me shumë sukses për dy nete 24 & 25 Shkurt 2023 në teatrin “Petro Marko”, me sallën plot me spektatore.
4. Drama “Osman Taka”, Regjite Naum Shundi, Autor Arben Iliazi & kastaktorësh fantastik Vin Bejleri, Olta Harizaj, Romir Zalla dhe Neritan Liçaj.
Drama u shfaq me shumë sukses me 19 mars 2023.
5. Në teatrin “Petro Marko” u zhvillua Java e kremtimeve të 110 Vjetorit të Klubit Shumësportesh Flamurtari “100 Vjet Flamurtari” 21-25 Mars 2023.
6. Koncert recital kantautorit Italian Pupo, në bashkepunim me Konsullatën Italiane Vlore, imbahtur me 30 mars 2023.
7. Komedia “Njedasme e hatashme”, një komedi tipike britanike, me regjite Kico Londo, shfaqur me shumë sukses në teatrin “Petro Marko”, në datat 1, 2 & 3 Prill 2023, një lojë e bukur e trupës së aktoreve të njohur Julian Dedën, Fatma Haxhialiu, Ermira Hysaj, Marjana Kondi, Denisa Demaj dhe Engjëll Hoxha.
8. Trupa e aktoreve të humorit “Al Pazar”, me drejtuesin e kësaj trupe, të talentuarin Z Agron Llakaj, tërmbushisallen e Teatrit Petro Marko, date 08 Prill 2023.

9. "Meladrama" ne skenen e Teatrit, opera dixhitale piano – soprano, kompozim i autores Olsa Toqe & dy soprano te mrekullueshme Marina Kurti dhe Viola Bakiasi shoqeruar ne piano nga vete autorja.
10. "Vrasje ne Paris", veper e autorit Eugene Labiche, me regji dhe pjesemarrje te Laert Vasili, sjelle ne skene nga nje kast i mrekullueshem aktoresh, Evanthi Pango, Artan Islami, Margent Caushi, si dhe me pjesemarrjen e vecante te mjeshtrit te varietese dhe parodise, "Mjeshtrit te Madh " Afrim Agalliu dhe solistit te talentuar vlonjat Viktor Tahiraj.
U shfaq me shumesukses pershtateneteneatrin "Petro Marko".
11. "Fest Art 2023" Njespektakelipervitshemitalentevetereja, nenvzhgimindhetajnimin e meprofesionistetefushhessidheorganizimin e Teatrit " Petro Marko " e Zyrës Vendore Arsimore Vlorë. konkurs, çmime e vlerësime.
Me talentet më të spikatur në të gjitha shkollat e mesme dhe klasave te 9 - ta të qytetit ne zhanrin e këngës dhe kercimit modern, mbajtur me 3 & 4 Maj 2023.
12. Data 18 Maj 2023 ne Teatrin "PETRO MARKO". Kengetaret e mirenjohur AMARA e SIMONE CRISTICCHI sollen per artedashesit Vlonjateqekishinte jmbushursallen e Teatrit, koncertin e titulluar " Torneremo Ancora" me kengetekompozuarangakantautoriimadhitalian FRANCO BATTIATO ne 2 vjetorin e largimittetijngajeta!
Duartrokitjetdeshoqerimetnekorngasallanukmunguangjategjithembremjes.
13. Date 25 Maj 2023, Koncertseleksionimiperfundimtaritrupeperfaqesuesete Qarkut Vlore ne Festivalin Folklorik Kombetarte Gjirokastres.
14. Koncert mekitare Gantiss-Zimmermann, 7 qershor 2023.
15. "Tanikenisy per te pare", njeveper e vene ne skene me regjite Klaudia Piroli
Autore, Lisa Karen Cox, Maggie Huculak, Raha Javanfar, Amy Nostbakken, Norah Sadava, and Cheyenne Scott.
Lojeaktorialembreselenese e trupes, Loredana Gjeçi, Enisa Hysa, Denada Llanaj, Artemis Beluli, shfaqur me 16 Qershor 2023.
16. Koncert me muzikedhome me veprate autoreveteshquar! Tre instrumentisteqedebutojne ne orkestrat me prestigjoret eeuropes, nje ne bashkepunim me ambasaden franceze, date 25 qershor 2023.
17. Koncert instrumental "Vale muzikore", me pjesemarrjen e sopranos tashme me nje fame europiane dhesoliste e teatrit kombetarte operas e baletit, vlonjatja e talentuar Nina Muhodhengabaritonisolistiteatrit kombetarte operas e baletit Sokol Hidersha, date 28 Qershor 2023.
18. "Nuk paguaj menukna e mbanxhepi", komedinga Dario Fo, me regjite Anila Balladhe me aktrimin e aktorëve: Ermela Ruri, Anila Balla, Julian Hurdha, Anxhelo Shkreli, Fatjon Biba, date 01 Korrik 2023.
19. "Yjesit", regjia Kriks Dumo, autor Nick Payne, nga Fondi I Teatrit per terinj, shfaqur ne Teatrin "Petro Marko" me 7, 8 & 9 Korrik 2023.
20. "Show Veror 2023", ne qendren historiketeqytetit te Vlores lagjja Muradie, 27 Korrik 2023.
"Show Veror"
aktivitetinjetraditeshumevjecareteketij institucioni i ideuar dhe organizuar nga Teatri " PETRO MARKO" Vlore dhembeshtetur nga Bashkia e qytetit te Vlores.
Spektakel nentinguajt e bukurate kengeve , ritmet e kercimit dhe atmosferen e humorit tekrijuar nga artistete Teatrit "Petro Marko" Vlore

,kengetaretemirenjohurdhezeraterinjtalentuar , aktoret e varietesedheteftuar , trupa e kercimit “ Star Dance” sidheParodistet e Vlores, per kenaqesine e pushuesvedheqytetarevlonjate.

21. “Magic Show”, vjennga Anglia Prestigjatori&Iluzionisti Edmond Murrajiciliargëtonshikuesit duke bërëlojëra me shpejtësi e shkathtësitëjashtëzakonshmedhe me mjeshtëritëveçantë, 28 & 29 Korrik 2023.
22. Koncert Duo Pianistike,Koncert I muzikesklasikeiartisteveItalianeqekanezgjedhurVloren per tepushuarporqenajapinedhekenaqesine me virtuozytetin e tyresipianiste duke nasjelleveprateautorevetemedhenjboterore, 04 Gusht 2023, ne Teatrin “Petro Marko”.
23. “Show Veror 2023”,Lungomare, 8 Gusht 2023
24. Ekspozite picture, Petraq Stefani, piktor nenëhollin e Teatrit “Petro Marko”, nga data 09 Gusht – 20 Gusht 2023.
25. “Show Veror 2023”,Orikum, 17 Gusht 2023.

Vlentëpërmendetkëtu, përveçkëtyreaktiviteteve, me ideator, mbështetësdherealizuesTeatrin “Petro Marko”, edhepjesëmarrjagjatëvitit e teatrovedheasambleveartistiketëftuar.

Përrealizimin e këtijaktivitetivjetor, fondet e planifikuaradhefondet e përdorurakanëqenë :

Shpenzimet operative (602)

Plan 602 – 7.050mije

Fakt 602 - 5.467mije

Investime (231)

Plan – 1 000mije

Fakt – 50mije

7. Projekti : Arsimi Parauniversitar

Programi : K09120 - Arsimi Parauniversitar

- **Arsimi**

Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit funksionon në bazë të ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.139/2015, dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,V.K.M Nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”,Udhëzim nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, VKB-ës nr.97, datë 28.12.2020 “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”, Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës",

Ligj Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” , Udhëzim, Nr.22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit

ushqimor, Ligj Nr.74/2013, date 14.02.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar.

- Në zbatim të udhëzimit nr.25, datë 25.07.2018 të MAS “Për bordin e institucionit arsimor”, Kreu 3, pika7: Bazuar në ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 34, është bërë Projekt –Vendim “Për përcaktimin e Përfaqësuesve të Bashkisë Vlorë në Bordet e Institucioneve Arsimore Publike dhe jo Publike”.

-Ngritja e një grupi pune brenda sektorit për analizën e situatës në kopshtet e Bahkisë Vlorë.

-Bazuar në urdhërin e brendshëm nr. 4 datë 10.01.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit edukativ individual për fëmijët me aftësi të kufizuar”, komisioni ka përditësuar planin PEI për 39 fëmijë me aftësi të kufizuar në kopshtet e Bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me mësueset mbështetëse (përditësimi cdo 3 muaj).

-Finalizimi i veprimtarisë me rastin e 7 - Marsit, festës së mëuesit, është organizuar në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore Vlorë – Himarë, veprimtaria me mësues që kanë dhënë kontribut të shquar në fushën e arsimit. U nderuan 19 mësues me titullin “Mirënjohje e Qytetit” .

-Është zhvilluar procesi i mbledhjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të bonusit financiar të nxënësve ekselentë të shkollave 9-vjecare dhe të mesme që aplikojnë në Bashkinë Vlorë. Janë trajtuar për vitin **shk. 2022-2023** me bonus financiar 145 nxënës në shkollat 9- vjecare publike dhe 123 nxënës në shkollat e mesme të përgjithshme publike.

-Bazuar në Ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, VKB-ës nr.97, datë 28.12.2020 “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”, ndiqet procesi i regjistrimit të vazhdueshëm në kopshte dhe çerdhe, si dhe adresimi i problematikave.

-Bazuar në Urdhërin e Brendshëm Nr.233, datë 23.10.2020 “Për një ndryshim në urdhërin Nr.3 DT 07.01.2020 mbi ngritjen e komisionit për kolaudimin e mallrave ushqimorë, industriale dhe elektrike” është kryer kontroll ditor i ushqimit për çerdhet, kopshtet dhe PLM pranë magazinës së Qendrës Ekonomike.

- Kthim përgjigje institucioneve të ndryshme.

-Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit për Çrregullimin e Spektrit të Autizmit janë zhvilluar disa aktivitete gjatë muajit Prill.

-Ndjekja e aktiviteteve sportive në kuadër të javës sportive dhe Ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe.

-Ndjekja e aktiviteteve të ndryshme sportive që zhvillohen në Bashkinë Vlorë dhe në shkollat e qytetit.

Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme që organizojnë drejtori të tjera të Bashkisë Vlorë.

8. Projekti : Qendra e Zhvillimit PAK dhe Shtëpia e Foshnjës

Programi : K10430 - Qendra e Zhvillimit PAK

- **Qendra e zhvillimit P.A.K**

Qendra e Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuar Vlorë si një institucion rezidencial i cili funksionon në përputhje me standartet dhe legjislacionin në fuqi për këtë target grup, edhe këtë vit ka organizuar aktivitetin e saj në përputhje me misionin dhe objektivat e vendosura.

Për 8-mujorin për vitin 2023 pranë Qendrës së Zhvillimit PAK kanë marrë shërbim 30 rezidentë, 10 prej të cilëve janë në interesim nga familjari dhe pjesa tjetër, prej 20 rezidentësh janë të braktisur me vendim gjykate. Në organikën e saj Qendra ka një staf prej 31 punonjësish të ndarë në 2 sektorë: Sektori i Administratës dhe Sektori i Shërbimeve.

Aktualisht faktike janë 29 punonjes, pasi 1 punonjes për arsyet e veta personale është larguar, dhe në presim zëvendesimin e tij

Misioni i kësaj qendre është zbatimi i politikave sociale me synim : Ofrimin e Shërbimeve cilësore, të qëndrueshme dhe në përputhje me standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat me Aftësi të Kufizuara duke qënë gjithnjë në koherencë me legjislacionin në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë së jetës, nxitjen e pavarësisë, përfshirjes dhe respektimit të dinjitetit të rezidentëve, si dhe integrimin e tyre në komunitet në mënyrë sa më të natyrshme, nëse kjo e fundit është e mundur.

Qendra e Zhvillimit për Persona me Aftësitë Kufizuara ka për Objektiv të:

- Rrisë cilësinë e shërbimit që ju ofrohet rezidentëve në drejtim të aftësisë fizike dhe mendore të këtyre të fundit.
- Nxitjen dhe zbatimin e programeve aktive me qëllim krijimin e një procesi sa më natyral të integrit të rezidentëve në komunitet.
- Krijimin i network-ve efektive me Institucione, Organizata Jofitimprurëse, Subjekte Juridike dhe Privatet të cilat promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e këtij target-grupi.
- Realizimin e Programeve edukativo-pedagogjike dhe aftësitë të mëdha të personave me aftësitë kufizuara.

Detyrat :

- Ofrimi dhe krijimi i kushteve të favorshme dhe cilësisë për të jetuar dhe mësuar në bazë të programeve të aftësisë.
- Përpilimi i programeve të edukimit dhe të integrit në saj të bashkëpunimit të edukatoreve, specialistëve, monitorimi i të cilave bëhet nga Drejtoria.
- Zbatimi i legjislacionit dhe Standarteve.
- Hartimi i programeve për trajnimin dhe formimin e stafit.
- Administron dhe menaxhon buxhetin e caktuar.
- Raporton dhe informon Sh.S.SH dhe Bashkinë Vlorë mbi: statistikat dhe evidencat mujore, të ardhurat, transferimet e klientëve, raporte të realizimit të planeve mujore.
- Mban lidhje korrekte për çdo problem me Bashkinë Vlorë dhe SH.S.SH.

Si Institucion Shtetëror, social dhe rehabilitues pjesë e institucioneve të përkujdesit shoqëror në këtë Qendër ofrohen këto shërbime :

- Në nivel specialisti, të përfaqësuar nga punonjësi social, infermier, specialist logoped dhe fizioterapeut, edukatorët të cilat mbulojnë edhe nivelin edukativ-pedagogjik.
- Në nivel shërbimi, të përfaqësuar nga kuzhinieret, kujdestaret, sanitaret, mirëmbajtësi, magazinieri etj.

Deinstitutionalizimi dhe kthimi në familje i rezidentëve.

Aktualisht në Qendrën tonë marrin shërbim 30 rezidentë, prej të cilëve 21 përfitues janë moshën 21 vjeçare, 15 janë të braktisur me vendim gjykatë dhe 6 janë në interesim familjar. Shërbimi Social Shtetëror udhëzon që Qendrat Rezidenciale të ofrojnë kujdes dhe shërbim për rezidentët deri në moshën 21 vjeç, si dhe të kryhen të gjitha procedurat për kthimin në familje të personave me interesim. Konkretisht janë kryer të gjitha kërkesat dhe procedurat ndaj Shërbimit Social Shtetëror dhe Rajonal për sistemimin e këtyre rezidentëve, por situacionet social-ekonomike të familjeve të tyre nuk i plotësojnë kushtet për deinstitutionalizimin e këtyre përfituesve.

Realizimet e objektivave

1. Realizimet në sektorin social dhe pedagogjik

Nëdrejtim të këtyre sektorëve qëllimet, objektivat dhe aktivitetet përgjate vitit 2023 kanë qenë të orientuara në lidhje me moshën në rritje të rezidentëve, të vështirësive që ata paraqesin nevojave dhe kërkesave të tyre në lidhje me trajtimin e aftësisë së kufizuar dhe të zhvillimit të tyre në përputhje me kërkesat dhe plotësimin e standarteve të vendosura.

Në nivel pedagogjik për kete vit janë vlerësuar fillimisht nevojat, kërkesat dhe vetë rezidentët brenda institucionit është hartuar një projekt pilot duke organizuar aktivitete okupacioni në bazë të trajnimeve speciale të edukatoreve të orientuara në aktivitete specifike. Që do të thotë se tashmë janë shtuar aktivitete paraprofesionale në mini atelie pune si: *punime me letër dhe plastikë, punime leshi, pikturë, aplikacione-prodhim pikturë të ndryshme.*

Aktivitet në Qendër janë zhvilluar normalisht, madje këtë vit mund të përmendim se ka patur një rritje në nivelin e organizimit të aktiviteteve

Rezidentët përfshihen në këto aktivitete në mënyrën që munden . Këto aktivitete zhvillohen paralelisht me programet individuale të zhvillimit për gjithë secilin nga rezidentët.

Theksojmë se të gjitha aktivitetet janë realizuar në mbështetje të plote të edukatoreve specialiste të cilët organizojnë punën në baze të prirjeve të scilit rezident.

Realizimi i objektivave pedagogjike

- Plotësimi i fishave të vlerësimit të AK, për të përcaktuar nevojat dhe prioritetet e ndërhyrjes.
- Hartimi, plotësimi i planeve individuale të zhvillimit.
- Rishikimi dhe rivlerësimi i nevojave të rezidentëve përsa i përket moshës dhe tipologjisë së vështirësisë që ata paraqesin, duke i orientuar aktivitetet në ato paraprofesionale.

- Hapja e 2 mini- atelieve të punës, e hekurosjes dhe e krijimtarisë me materiale të ndryshme sipas specifikave të rezidentëve.

2.Ecuria shëndetësore e përfituesve.

Përsa i përket gjendjes shëndetësore të rasteve, aktualisht janë 19 përfitues me mjekim ditor për shkak të çrregullimeve psikiatrike apo neurologjike. Mjekimi është i udhëzuar dhe dokumentuar nga mjeku specialist dhe menaxhohet nga infermieri i institucionit. Janë realizuar të gjitha ekzaminimet e udhëzuara nga mjeku.

Ushqimi është korrekt në lidhje me kuotën ushqimore të percaktuar për secilin rezident dhe mund të vlerësohet një menu brenda parametrave normal përsa i përket kalorive duke përfshirë aty edhe moshën dhe dietën e rezidentëve.

Gjendja shëndetësore e rezidentëve ka qenë relativisht e mirë, duke patur parasysh këtu kategorinë e personave, problemet dhe vështirësitë që ata kanë. Në periudha të ndryshme të vitit janë shfaqur viroza të cilat janë trajtuar si në individ, po ashtu edhe kur rastet kanë qenë kolektive. Gadishmëria dhe dispozicioni i mjekëve ka qenë shumë i kënaqshëm dhe korrekt.

Është bërë në mënyrë korrekte vaksinimi i rezidentëve sipas kalendarit të vaksinimit, si dhe kontrollet rutine përsa i përket planifikimit nga ana e infermieres në lidhje me kontaktimin me mjekët përkatës.

2. Realizime në sektorin financiar.

Gjatë 2023 nga Bashkia na është akorduar një fond prej 16,202,000 lekë, i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Zërat	Plani vjetor 2023	Fakt 8-mujor -2023
600	9246000	4'801'868
601	1,470,000	799763
602	4,610,000	1'413'717
231	2,000,000	1'021'400
Totali	17,326,000	799763

Programi : K10430 - Shtëpia e Foshnjës

- **Shtëpia e Foshnjës**

Institucioni ynë Shtëpia e Foshnjës Vlorë ka një kapacitet prej 30 fëmijësh . Aktualisht janë akomoduar 3 fëmijë fëmijë ku 2 fëmijë janë në proces biresimi dhe 1 fëmijë cështje në apel Në buxhetin e vitit 2023 janë akorduar fonde për : (000) lekë

Paga	7.530	lekë
Sigurime	1.257	lekë
Shpenzime operative .	2.000	lekë
Blerje pajisje	770	lekë

Për 8 mujorin e vitit 2023 është kjo gjendje sipas situacionit
Në 8 mujorin e vitit 2023 në llogarinë 602 “ shpenzime operative “ është shpenzuar për artikujt

1- Dieta	32.300	lekë	
2- Kolaudim fikse zjarri	14.400	lekë	
3- Roje	368.000	lekë	(deri tani kontrata)
4- Detergjenta	110.400	lekë	
5- Ene kuzhine	68.980	lekë	
6- Materiale elektike dhe hidraulike	70.000	lekë	
Totali	664080	lekë	

Per llogarine 231 eshte shpenzuar :

1- Blerje skaner+printer	70 000	lekë
--------------------------	--------	------

Per llogarine 602 kap 6 (të ardhura nga donatorë) jane shpenzuar :

1. Organizim ditelindje	24.000	lekë
-------------------------	--------	------

Konceptoi: Drejtori i D.F.B.K
H.Haxhaj

KRYETAR

Ernal DREDDHA

